

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Viti i 91-të i botimit
Janar 2023 / Nr. 1

Mbrojtja



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Krenarë për FA-të, na kanë dhënë të drejtën të kemi një pozicion të merituar në NATO

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji: Mbështetja dhe përpjekjet e mia do të mbeten të pakufizuara ndaj çdo ushtaraku të FA-së

Presidenti Begaj: Ju jeni aset më i çmuar i FA. Faleminderit për shërbimin që i bëni kombit!

Përmbajtja

Numri 1

MARRËVESHJA

- 10** Peleshi: Avionët luftarakë "Bayraktar", me rëndësi për sigurinë tonë kombëtare dhe të Aleancës

BAZA AJRORE E FARKËS

- 22** 55 vjet fluturime humanitare, sakrificë, përgjegjësi

SOCIALE

- 34** "Nëse Shekspiri do të ishte grua, nuk do të kish patur kurrë kohë për t'u bërë një gjeni"

XHUBLETA SHQIPTARE

- 42** Veshja unike, tashmë pasuri e gjithë njerëzimit

HISTORI

- 50** 110 vjet shtet shqiptar, rrugëtim, sfida, krenari kombëtare

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktore

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore / korrektore:
Suela HODA



4 FORCAT E ARMATOSURA

Presidenti Begaj: Ju jeni aset më i çmuar i FA. Faleminderit për shërbimin që i bëni kombit!

Presidenti i Shqipërisë Bajram Begaj, i ka uruar të gjithë ushtarët shqiptarë që shërbejnë në misione ndërkombëtare me rastin e fillimit të vitit të ri 2023. Presidenti Begaj...



8 MINISTRI NIKO PELESHI

"Shqipëria, aleat i besueshëm i Aleancës, të gatshëm të vëmë në dispozicion infrastrukturën tonë"

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën Supreme të Aleancës në Europë. Ai u prit në një takim nga Komandanti Suprem...



14 CEREMONIA

Kremtohet 97 - vjetori i Forcës Detare

Në Portin e Durrësit u zhvillua një ceremoni me rastin 97 - vjetorit të krijimit të Forcës Detare. Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura...



28 INTERVISTË ME KUNDËRADMIRAL ADNAN AGASTRA

Forca Detare, 97 vjet lundrim nëpër histori suksesi

"Kur të shkruhet historia e lundrimit botëror, ujërat e brendshme të Shqipërisë do të japin material shumë interesant, që u përket kohërave më të lashta të historisë..."

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 91-të i botimit
Nr. 1/ 2023

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

*Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:*

*[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*



Presidenti Begaj:
Ju jeni asetë më e çmuar
e Forcave të Armatosura. Faleminderit
për shërbimin që i bëni kombit!

Viti 2022 ishte një vit shumë i vështirë, ku agresioni i pajustificuar i Rusisë ndaj Ukrainës rrezikoi paqen dhe sigurinë në hapësirën euroatlantike, ndërsa efektet e saj ndihen në jetën e çdo qytetari.

Presidenti i Shqipërisë Bajram Begaj, i ka uruar të gjithë ushtarët shqiptarë që shërbejnë në misionet ndërkombëtare me rastin e fillimit të vitit të ri 2023.

Presidenti Begaj shprehu vlerësimin e tij për ushtarakët, që shpesh dhe në raste festash ndodhen larg familjeve të tyre, duke shërbyer nga Kosova në Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Letoni, Irak dhe deri në Sudanin e Jugut.

“Shërbimi juaj përkrah aleatëve është një shërbim që përshkohet nga sakrificat, përkushtimi, përgjegjshmëria dhe disiplina e lartë që karakterizon Forcat e Armatosura”, - tha Begaj.

Më tej presidenti theksoi se viti 2022 ishte një vit shumë i vështirë, ku agresioni i pajustificuar i Rusisë ndaj Ukrainës rrezikoi paqen dhe sigurinë në hapësirën euro-atlantike, ndërsa efektet e saj ndihen në jetën e çdo qytetari.

Begaj shtoi se Shqipëria si anëtarë e NATO-s do të vazhdojë të japë kontributin e saj: “Si anëtar i NATO-s, vendi ynë do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive në misionet dhe operacionet të drejtuara nga NATO, si dhe do të rrisim kontributet tona aty ku do të jetë e nevojshme dhe do

të na kërkohej", - shtoi Begaj.

“Këto ditë kam ndjekur me shqetësim ngjarjet në veri të Kosovës. Shqipëria si një vend anëtar i NATO-s është e përkushtuar dhe mbështet misionin e KFOR-it, që ne e cilësojmë si një histori suksesi. Unë ju falënderoj ju si kontingjent që jeni atje, për të gjithë përkushtimin e treguar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë”, - theksoi ai.

“Forcat e Armatosura janë shumë të rëndësishme për një vend dhe unë sot nëpërmjet jush gjej rastin të falënderoj të gjitha Forcat e Armatosura shqiptare për përkushtimin e treguar në përm-bushjen e çdo detyre kushtetuese, por edhe në përballimin e atyre situatave të cilat kanë qenë jo të pakta gjatë vitit, si emergjencat e ndryshme”, - shtoi më tej Presidenti. “Për mua, ju jeni aset i çmuar i Forcave të Armatosura. Mund të marrim pajisje mjaft të mira teknologjike, por nëse nuk kemi njerëz për t’i përdorur ato nuk kemi bërë asgjë. Me këtë rast edhe njëherë ju uroj festa të gëzuara, shëndet e mbarësi për ju dhe familjet e juaja. Gëzuar Vitin e Ri 2023! Shumë fale-minderit për shërbimin që i bëni kombit”, - e mbylli falënderimin presidenti Begaj.





Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Krenarë për FA-të, na kanë dhënë të drejtën të kemi një pozicion të merituar në NATO

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, zhvilluan një bashkëbisedim online me të gjithë përfaqësuesit e Shqipërisë në misione jashtë vendit, të cilët i përgëzuan për kontributin dhe punën e bërë gjatë këtij viti tejet të ngarkuar për sigurinë dhe paqen në botë.

"Gjatë vitit që po lëmë pas, puna juaj dhe e FA-së dhe në veçanti e atyre që janë në misione ndërkombëtare ka marrë një tjetër përmasë. Ky ishte një vit me lajme jo të mira për sigurinë dhe paqen, ishte një vit kur skena e sigurisë u trondit për shkak të invazionit rus në Ukrainë dhe kjo bëri që siguria

dhe paqja si domain të vendosen në qendër dhe të jenë prioritet i prioritetëve për të gjithë botën", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi e nisi bisedën me Missionin e Shqipërisë pranë KFOR-it në Kosovë, duke folur edhe për situatën atje. "Së fundmi tensioni është rritur. Ju jeni pjesë e KFOR-it, e strukturës së NATO-s që garanton sigurinë. Të gjitha fenomenet që kërkojnë të krijojnë destabilitet në

rajon janë derivat i asaj çka ndodhi në shkurtin e këtij viti në Ukrainë dhe vazhdon të jetë sot një nga shqetësimet kryesore të botës. Kjo ngjarje na vuri përpara detyrave, të cilat nuk i kishim menduar në një kohë kaq të afërt, lidhur me modernizimin, lidhur me investimet në arsimim, në shtimin e prezencës sonë në misione ndërkombëtare, pra në ndërtimin e një force të armatosur më të fortë, më të aftë dhe më shpresëdhënëse

për të gjithë bashkatdhetarët tanë në Shqipëri, por edhe në rajon, për të garantuar paqen dhe sigurinë në Ballkan dhe në të gjithë hapësirën e Aleancës së NATO-s", - theksoi ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes foli për një dimension të ri që ka marrë bashkëpunimi me NATO-s, ku përmendi aleancën strategjike me SHBA-të, por edhe bashkëpunimin me BE-në, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e përfaqësuesve tanë në këto misione të rëndësishme: "Ju bëni krenar sot të gjithë popullin shqiptar. Ju jeni një vlerë e shtuar edhe në NATO. Ndonëse jemi një popull i vogël, një aleat i vogël, ne duam të tregojmë se nuk jemi vetëm konsumatorë, por edhe duam të kontribuojmë. Ne jemi me forca më të shtuara në misionet e NATO-s. Kemi një reputacion shumë të mirë. Ju na keni hapur syrin dhe na keni dhënë gjithë të drejtën të kemi një pozicion shumë të merituar në NATO", - u tha ministri Peleshi përfaqësuesve të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare.

Gjatë bisedës, z. Peleshi foli edhe për objektivat që Ministria e Mbro-

jtjes ka për vitin 2023: "Ky është viti kur ne bëme një ndryshim sasior dhe cilësor në shpërblimin e FA-së. Kemi rritur 30% pagat për të gjithë efektivet, nga ushtari bazë dhe deri te gradat më të larta. Angazhimi dhe premtimi i kryeministrit për të patur një rritje të vazhdueshme dhe të përvitshme deri sa të arrijmë nivelin më të lartë në rajon do të realizohet. Vitin që vjen do e rrisim edhe 7 % të tjera pagën mbi atë 30% që u rrit gjatë vitit 2022", - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas tij, në 2023 fillon puna për ndërtimin e korpusit të Akademisë së FA-së, ndërsa Flota e Forcës Ajrore do të shtohet edhe me helikopterë të tjerë "Black Hawk", duke e çuar në 6 numrin e helikopterëve.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se është bërë mjaft progres në punën për ndërtimin e Bazës së parë Taktike Ajrore të NATO-s në Kuçovë dhe pritet që për rreth një vit ajo të jetë gati.

Një tjetër projekt i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin që vjen është edhe ndërtimi i një porti të

ri ushtarak në Porto Romano pranë portit tregtar, i cili, sipas ministrit Peleshi, do t'i japë Shqipërisë një rëndësi të shtuar strategjike, pasi ky port do të jetë porta e hyrjes dhe e dislokimit të forcave aleate nga Ballkani Perëndimor drejt Lindjes.

Duke uruar përfaqësuesit e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare jashtë vendit, ministri Peleshi tha se viti që vjen do të jetë më i mirë edhe për sigurinë, pasi të gjithë aleatët janë bashkuar në krahun e paqes.

Edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji vlerësoi misionin e përfaqësuesve tanë, duke theksuar se: "Viti 2023, për të gjithë ne, vjen me detyrime të reja edhe më të shumta, por unë ju siguroj se edhe vëmendja dhe mbështetja e të gjithë autoriteteve të vendit, do të jetë shumë më e shtuar dhe e ndjeshme gjatë vitit 2023. Forcat e Armatosura do të jenë edhe më mirë, por njëkohësisht do të bëjnë edhe më të mirën gjatë vitit që vjen".



Të dashur ushtarakë dhe punonjës civilë të Forcave të Armatosura! Atmosfera festive e këtij fund viti na sjell së bashku me familjet, miqtë, shokët e kolegët, për të festuar me njëri-tjetrin.

Teksa reflektojmë mbi dymbëdhjetë muajt që lamë pas, e vlerësoj me admirim punën dhe përkushtimin tuaj në realizimin e detyrave që ju janë ngarkuar. Të gjithë ne, jemi krenarë që punojmë përkrah njerëzve të motivuar dhe të dedikuar në këtë profesion sa fisnik dhe sfidues, që bën diferencën në komunitetet tona ku jetojmë dhe shërbejmë.

Disa prej nesh këto festa i gjejnë larg atdheut, në krye të detyrës krah për krah me aleatët tanë. Forcat e Armatosura vijnë kontributin e rëndësishëm në misionet jashtë vendit, si Kosovë, Letoni, Bosnjë - Hercegovinë, Bullgari, Irak dhe Sudanin e Jugut, ku mbajnë lart emrin dhe flamurin e vendit.

Një kontribut të rëndësishëm kemi shënuar edhe në mbështetje të organeve të pushtetit qendror dhe popullsisë gjatë emergjencave të ndryshme civile. Efektivët tanë janë të parët që janë aty për të mbështetur edhe kur emergjencat dhe nevojat i kalojnë kufijtë e mundësive të këtyre institucioneve.

Përgjatë vitit 2022, njësitë tona u angazhuan në stërvitje të shumta brenda dhe jashtë vendit, të cilat përfshinë një shkallë të gjerë trupash, mjetesh, pajisjesh, si në stërvitje dimërore, verore, po ashtu në stërvitjet bilaterale dhe shumëkombëshe në bashkëpunim me vendet partnere strategjike dhe aleate. Këto stërvitje, përpos testimit të kapaciteteve operacionale, kanë rritur ndjeshëm ndërveprueshmërinë dhe gatishmërinë e njësive tona për t'u përgjigjur në çdo situatë dhe në çdo kohë. Forcat e Armatosura tashmë kanë në përbërjen e tyre një grup - batalion të gatshëm në shërbim të nevojave të Aleancës.

Viti 2023 do të vijojë të jetë i mbushur me detyra dhe sfida, të cilat jam më se i bindur se në sajë të eksperiencës dhe përkushtimit tuaj do të arrijmë t'i përballojmë me sukses.

Përpara na presin dy stërvitje të



SHSHPFPA, gjeneral brigade Arben Kingji: Mbështetja dhe përpjekjet e mia do të mbeten të pakufizuara ndaj çdo ushtaraku të FA-së

mëdha me rëndësi kombëtare: "Defender Europe - '23" dhe "Strong Balkan - '23", ku kërkohet nga ne një angazhim serioz dhe ku do të dëshmojmë se FA-të kanë kapacitetet e duhura të veprojnë dhe ndërveprojnë si një forcë kohezive e përbashkët.

Modernizimi, investimet në infrastrukturë dhe përmirësimi i kushteve për jetesë dhe stërvitje do të jetë prioriteti ynë, duke ndërthurur standardet më të mira në fushën e arsimimit, edukimit, trajnimit dhe stërvitjes, me synim zhvillimin e një force të armatosur me aftësi dhe kapacitete reale për të zgjidhur me sukses situata të krizave të ndryshme dhe të krye-

jnë shërbime jetike për vendin dhe gjatë angazhimeve ndërkombëtare, si pjesë e NATO-s.

Sot është dita e duhur për të përshëndetur të gjithë pjesëtarët e Forcave të Armatosura, që kanë shërbyer ndër vite dhe ata që vazhdojnë dhe shërbejnë, prandaj ju drejtohem për t'ju përcjellë nga zemra juve dhe familjeve tuaja, urimet më të mira për një Vit të Ri me shëndet dhe i mbushur me gëzime në të gjitha fushat.

Duke ju siguruar se mbështetja dhe përpjekjet e mia do të mbeten të pakufizuara edhe njëherë, kujdesuni për veten, familjet tuaja dhe njëri - tjetrin!



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: **Shqipëria, aleat i besueshëm** i Aleancës, të gatshëm të vëmë në dispozicion infrastrukturën tonë



NATO dhe SHBA-të, duhet të promovojnë dhe investojnë me këmbëngulje në reformën e sektorit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

zhvillimi i kapaciteteve të FARSH dhe modernizimi.

Ministri Peleshi ndër të tjera vlerësoi rolin vendimtar të Komandës Supreme të Aleancës në materializimin e objektivave politike të NATO-s dhe mbi të gjitha punën e matur për përballjen me sfidat aktuale në kufijtë e Aleancës, pa shkëputur vëmendjen nga rajoni i Ballkanit. Ai theksoi rëndësinë e prezencës së trupave të NATO-s në lindje, Letoni dhe Bullgari dhe njëkohësisht në KFOR, Kosovë. NATO dhe SHBA-të, sipas ministrit Peleshi, duhet të promovojnë dhe investojnë me këmbëngulje në reformën e sektorit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Rëndësi të veçantë iu kushtua rolit të Shqipërisë, si një aleat i besueshëm dhe kontribuues aktiv për garantimin e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë, por në të njëjtën kohë dhe pozicionit strategjik, që vendi ynë ka për mbështetjen e vazhdueshme logjistike në kufirin lindor të Aleancës. Në takim u vlerësua rëndësia që qeveria shqiptare i ka kushtuar zhvillimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve të porteve dhe ndërtimit të "Korridorit VIII", si projekte thelbësore për aksesin e menjëhershëm të forcave të NATO-s në brendësi të Ballkanit deri në Detin e Zi. Ministri i Mbrojtjes shprehu gatishmërinë e vendit tonë për të ndërtuar këtë infrastrukturë sipas standardeve



të NATO-s dhe vendosjen e saj në dispozicion të Aleancës. Komandanti Suprem i Aleancës për Europën, gjeneral Christopher G. Cavoli, njëkohësisht dhe komandanti i Komandës Amerikane për Europën, shprehu mirënjohjen e tij për rolin e Shqipërisë si një aleat dinjitoz dhe tepër dinamik në NATO, kontributin e vendit tonë për Aleancën dhe vullnetin e shprehur në vazhdimësi. Gjeneral Cavoli vlerësoi rolin dhe profesionalizmin e ushtarakëve shqiptarë që shërbejnë në komandat dhe misionet e NATO-s. Gjatë aktivitetit, ministri i Mbrojtjes u takua edhe me personelin ushtarak shqiptar që shërben në SHAPE. Peleshi i falënderoi ata për punën e mirë dhe përfaqësimin dinjitoz në komandën kryesore të NATO-s.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën Supreme të Aleancës në Europë. Ai u prit në një takim nga Komandanti Suprem i Aleancës për Europën, gjeneral Christopher G. Cavoli, njëkohësisht dhe komandanti i Komandës Amerikane për Europën. Gjatë takimit u diskutua mbi mjedisin aktual të sigurisë, sfidat në kufirin lindor të Aleancës, bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s, partneriteti strategjik me SHBA-të,



Peleshi: Avionët luftarakë “Bayraktar”, me rëndësi për sigurinë tonë kombëtare dhe të Aleancës

Në prani të kryeministrit Edi Rama, ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, përfaqësuesve të firmës turke “Baykar Technologies”, ambasadorit të Republikës së Turqisë në vendin tonë Tayyar Kağan Atay, u nënshkrua në Tiranë marrëveshja për sigurimin e avionëve luftarakë pa pilotë “Bayraktar”.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë fjalës së tij shprehu mirënjohje për ndihmën që qeveria turke ka dhënë vitet e fundit në mbështetje të Forcave të Armatosura: “Jam i sigurt se shfrytëzimi i këtyre aseteve në vendin tonë do të rrisë cilësisht kapacitetet e Forcave të Armatosura dhe strukturave të Emergjencave Civile në drejtim të kontrollit të territorit dhe për të parandaluar fenomenet e paligjshme. Kompletimi me këtë sistem ka rëndësi të veçantë për sigurinë tonë kombëtare dhe atë të Aleancës, si dhe për respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe objektivat e Kapaciteteve të NATO-s”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ministri Peleshi shpjegoi edhe objektivat që kërkohen të arrihen përmes shtimit të këtyre kapaciteteve: “Krijimi i kapaciteteve kombëtare shumëpërdorimshme dhe modulare për zbulim, vëzhgim dhe rikonicion më të mirë, në mbështetje ajrore të operacioneve të FARSH dhe gjatë operacioneve të emergjencave civile dhe operacioneve në ndihmë të komunitetit, do të jenë disa prej objektivave që do të arrihen me sigurimin e këtyre aseteve. Modernizimi i Forcave të Armatosura do të jetë në vëmendje të vazhdueshme

të qeverisë shqiptare. Gjatë viteve të fundit kemi bërë të mundur investime konkrete për trajtimin dhe trajnimin e personelit ushtarak, si dhe në blerje të pajisjeve, aseteve të rëndësishme në funksion të Forcave të Armatosura.

Kompletimi më këto sisteme ka rëndësi të veçantë për sigurinë tonë kombëtare dhe atë të Aleancës, si dhe vjen në respektim të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe objektivat e Kapaciteteve të NATO-s”, - theksoi z. Peleshi

Nga ana e tij, mes të tjerash kryeministri Rama tha: “Me këtë marrëveshje nuk po sjellim këtu në Shqipëri teknologjinë më të mirë të lartë në këtë fushë, por kështu do sjellim në Shqipëri një fushë të re njohurish dhe është shumë mirë që

marrëveshja nuk është vetëm për të blerë dronët por ka të bëjë edhe me ndërtimin e një ure mes FA-ve tona dhe kompanisë Bajraktar që do kujdeset për trajnimin e njerëzve, më shumë se 30 persona që do përzgjidhen me shumë kujdes me ndihmën e kompanisë “Bayraktar”, që do vihen në një trajnim dhe do përgatiten për të marrë funksionin e qendrës së kontrollit, që do jetë objekt i teknologjisë më të lartë në bazën ajrore të Kuçovës”.

Firma “Baykar Technologies” është e specializuar në hartimin e teknologjive transformuese në fushën e Mbrojtjes dhe Aviacionit. Pajisja me këta avionë do t’u ofrojë institucioneve të tjera të qeverisë shqiptare një mbështetje të madhe në nivel operacional, në fusha të ndryshme.



Takimi i Ministrave të Mbrojtjes të Kartës së Adriatikut A-5

Ministrat e Mbrojtjes së Kartës së Adriatikut A - 5 (US - Adriatic Charter A-5) u takuan në Budva, Mali i Zi. Takimi u kryesua nga pala malazeze, si vendi drejtues i Kartës së Adriatikut - A5.

Në të morën pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga vendet anëtare, Shqipëria, Kroacia, Bosnje - Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe SHBA-të, si dhe në rolin e vendit vëzhgues, ministri i Mbrojtjes së Kosovës dhe përfaqësues të Sllovenisë dhe Serbisë. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, për shkak të angazhimeve me rastin e 110 - vjetorit të Pavarësisë, u përfaqësua në takim nga z. Blerim Çaka, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Mbrojtjes.

Tematikat kryesore, ku u fokusua takimi, ishin mbi situatën aktuale dhe sfidat globale të sigurisë, me fokus të veçantë mbi zhvillimet në Ukrainë, pasojat e mundshme mbi sigurinë në rajon, adresimi i tyre në mënyrë kolektive, bashkëpunimi rajonal dhe angazhimet në mbështetje të paqes dhe stabilitetit në kuadër të A - 5, si dhe u dakordësuan mbi konceptin e Rivitalizimit të Kartës së Adriatikut.

Të gjithë të pranishmit dënuan njëzëri agresionin në Ukrainë, shprehën shqetësimin për situatën aktuale në kufirin lindor, ndikimi në rajonin tonë, si dhe shpalosën vendosmërinë për një mbështetje të mëtejshme materiale dhe humanitare për garantimin e lirisë dhe sovranitetit të vendit.

Nga të gjithë vendet anëtare u theksua fakti që Karta e Adriatikut ka luajtur dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e integritetit të vendeve të rajonit në



NATO dhe në Bashkimin European, si rruga kryesore për garantimin e sigurisë dhe paqes në rajon. Nga të pranishmit u vlerësua marrja e statusit kandidat për anëtarësimin në Bashkimin European të Bosnje - Hercegovinës. Në të njëjtën kohë iu bë thirrje instancave të BE-së për të ruajtur ritmin dhe integritet plotë europian të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, për të shmangur ndikime të mundshme nga vende si Rusia apo Kina.

Përfaqësuesi i vendit tonë, duke mbështetur fuqishëm politikën e dyerve të hapura, kërkoi anëtarësimin e Kosovës në Kartën e Adriatikut, duke arritur një vendim konkret nga të gjithë anëtarët

dhe vlerësuar kërkesën e bërë prej kohësh.

Përfaqësuesi i Lartë i palës amerikane, znj. Celeste Wallander, asistente e Sekretarit të Mbrojtjes për Çështjet Ndërkombëtare të Sigurisë, ndër të tjera shprehu mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-së në përballien me sfidat e sigurisë dhe, në të njëjtën kohë, theksoi rolin e veçantë të Kartës së Adriatikut në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përballien me sfidat aktuale të sigurisë, sidomos me angazhime në kuadër të Mbrojtjes Kibernetike dhe veprimeve ushtarake të Rusisë në Ukrainë.

Në fund të takimit u firmos deklarata e përbashkët.



Peleshi: Financim 30 milionë euro për logjistikën në emergjencë

Qeveria miratoi, marrëveshjen ndërqeveritare me Republikën e Italisë për ngritjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi në përfundim të mbledhjes se ky është një angazhim i Italisë që në Konferencën e Donatorëve pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, që premtoi të mbështesë sistemin e Mbrojtjes Civile të Shqipërisë me një financim në formë huaje prej 30 milion eurosh.

"Kredia parashikon mbështetjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile, që nuk i përket një institucioni. Drejtohet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes, por është i shtrirë në të gjithë territorin dhe të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli lokal, bashkitë, prefekturat. Pothuajse i gjithë sistemi preket pozitivisht, pra merr financim nga kjo kredi 30 milion euro", - sqaroi ministri i Mbrojtjes, sipas të cilit marrëveshja do të kalojë në Parlament për ratifikim dhe më pas do të jetë aktive. Sipas ministrit Peleshi plani parashikon ndërtimin e një qendre të mirë pajisur me teknologji të standardeve të B-së në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile: "Paralel me të në të gjitha prefekturat dhe në katër qendrat e Agjencisë së Mbrojtjes Civile në territor do të ndërtohen sallat operacionale të pajisura dhe të lidhura me njëra-tjetrën me rrjet duke qenë ndërvepruese. Pranë qendrave të Mbrojtjes Civile do të ndërtohen edhe struktura operacionale të kërkim-shpëtimit shoqëruar edhe me pajisje, por dhe trajnim. Pra do ketë edhe shtrirje territoriale në katër qendra nëpër Shqipëri, por dhe të gjitha pajisjet në rastet e fatkeqësive natyrore. Për të gjitha bashkitë, strukturat zjarrfikëse në rang kombëtar parashikohet blerja e automjeteve zjarrfikëse dhe automjeteve të tjera si dhe gjithë logjistika për përmbytjet dhe kërkim-shpëtimin në përgjithësi", - tha Peleshi.

Pjesë e këtij financimi është edhe



blerja e dy mjeteve ajrore specifike për luftën kundër zjarreve. "Gjithashtu do të ngrihet një kamp trajnimi për zjarrfikësit dhe të gjitha strukturat operacionale, që duhet të trajnohen, duke përfshirë dhe vullnetarë, Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura. Kjo qendër trajnimi do jetë e pajisur edhe me laboratorë simulimi, pra le të themi me këtë financim e ngremë në një nivel të lartë gjithë Sistemin e Mbrojtjes Civile. Shpresoj ta kalojmë sa më shpejt në parlament. Tashmë është bërë traditë që për marrëveshjet ndërkombëtare votohet në unison dhe nuk ka dyshime se së shpejti kjo marrëveshje do miratohet dhe aktivizohet menjëherë", - tha Peleshi. I pyetur edhe nga media, pas mbledhjes së qeverisë, ministri i Mbrojtjes foli edhe për diskutimet me komandantin Suprem të NATO-s në Evropë për ndërtimin e një baze ushtarake në një pjesë të portit të ri tregtar të Porto Romanos. Peleshi tha se kjo mund të ndërtohet sipas modelit të Bazës Ajrore të NATO-s në Kuçovë. "Një nga pikat e diskutimit ka qenë mundësia

e mbështetjes nga NATO të portit ushtarak pranë portit të ri të Porto Romanos. Ky është lajm i rëndësishëm për Shqipërinë. Siç e ka thënë komandanti suprem i NATO-s para një viti, kur ishte këtu në Shqipëri, Durrësi si nyje hyrëse për në Ballkanin Perëndimor dhe në krahun lindor të NATO-s është i rëndësishëm për NATO-n. Ajo që po i ofrojmë ne NATO-s është që kjo hyrje të jetë sipas standardeve të NATO-s. Ne jemi duke u konsultuar me NATO-n sipas dizajnit të NATO-s. Krahas konsultimeve ne po punojmë edhe për financimin. Ka disa opsione për financimin, ka një burokraci që nuk shmanget dot, por ka hyrë në diskutim nga strukturat e NATO-s edhe kjo mënyrë financimi. Kemi një model të ngjashëm që është Baza e Kuçovës. Po ecën me ritme të shpejta. Ka qenë një pikë diskutimi, një investim shtesë për të ndërtuar qendrën e kontrollit të trafikut ajror aty, në Kuçovë, që mund të kushtojë rreth 20 mijë euro të tjera. Shpresoj që të miratohet. Por mbi atë model mund të ecim me Porto Romanon", - sqaroi ministri Peleshi.

Komandanti i Komandës Supreme Aleate të Transformimit të NATO-s, gjeneral Philippe Lavigne, pritet nga gjeneral brigade Arben Kingji

Komandanti i Komandës Supreme Aleate të Transformimit të NATO-s (ACT), gjeneral Philippe Lavigne zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë, ku u prit me truproje nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji.

Gjatë takimit në Shtabin e Përgjithshëm, gjeneral brigade Kingji e njohu gjeneral Lavigne me zhvillimet më të reja të FARSH, si dhe rolin që ka Shqipëria në kontekstin e bashkëpunimit dhe sigurisë rajonale e më gjerë. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit kanë ndarë pikëpamjet në tematika të ndryshme, duke u ndalur në rëndësinë e rritjes së kapaciteteve të mbrojtjes nga vendet anëtare, si dhe implementimit të vendimeve të Samitit të NATO-s në Madrid.

Një tjetër temë e rëndësishme gjatë takimit të dy drejtuesve të lartë ushtarakë ishte rreth koncepteve që Komanda e Transformimit po zhvillon për formësimin e instrumentit ushtarak të së ardhmes, për të qenë në gjendje për të kuptuar realitetin e ri gjeostrategjik dhe për të ndërvepruar e punuar së bashku në përballimin e sfidave të së ardhmes.



SHSHP, gjeneral brigade Arben Kingji, pret zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të NJ, gjeneralmajor Michael Wickman

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, pret në takim zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, njëkohësisht shef i Shtabit të USAEU-AF, gjeneralmajor Michael Wickman. Në fokus të bisedimeve ishte bashkëpunimi i mëtejshëm dhe stërvitjet e përbashkëta me ushtrinë amerikane, ndihma e madhe e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, si dhe përgatitjet mbi stërvitjen "Defender Europe-23". Gjeneralmajor Wickman u njoh me projektet e përmirësimit të kapaciteteve operacionale të FARSH-së. Nga ana e tij, gjeneral brigade Arben Kingji shprehu mirë-



njohjen për SHBA-të për asistencën në këtë proces, si dhe mbështetjen e jashtëzakonshme në fusha të tjera të bashkëpunimit ushtarak.





Kremtohet 97 - vjetori i Forcës Detare

Në Portin e Durrësit u zhvillua një ceremoni me rastin 97 - vjetorit të krijimit të Forcës Detare. Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, ish - komandantë të Forcës Detare ndër vite, përfaqësues të pushtetit vendor. Gjatë fjalës përshëndetëse, shefi Shtabit të Përgjithshëm theksoi se: "Forca Detare është zhvilluar dhe modernizuar në përputhje me konceptin e ri të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, si anëtar i NATO-s dhe kandidat i BE dhe, si e tillë, ajo ka kontribute të veçanta në misione e detyra brenda dhe jashtë vendit.

Angazhimi disavjeçar në misionin e NATO-s në detin Egje, gjatë të cilit janë shpëtuar mijëra jetë njerëzish, është një eksperiencë dhe një medalje nderi për Forcën Detare, një vlerë për Forcat e Armatosura dhe një krenari e dinjitet për vendin. Jo në pak raste këto detyra kanë qenë jo vetëm të vështira, por edhe të rrezikshme. Personel nga Forca Detare shërbejnë me dinjitet dhe profesionalizëm gjithashtu edhe në struktura dhe komanda të Aleancës siç ishte dhe Operacioni "Sea Guardian" në detin Egje", - u shpreh shefi Shtabit të FA. Gjithashtu, koman-



danti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra u shpreh se: "Forca Detare si rezultat i rritjes së ndjeshme të kapaciteteve të saj operacionale, vitet e fundit ka kryer me sukses detyrat të cilat i janë ngarkuar, qofshin ato kombëtare, rajonale apo edhe në kuadër të Aleancës. Forca Detare përfaqësoi me sukses vendin tonë gjatë pjesëmarrjes me anijen e klasit 'Iliria', në

aktivitetin e NATO-s në detin Egje, duke u radhitur të barabartë me kolegët e tyre të NATO.

Forca Detare gjithashtu është përfaqësuar denjësisht edhe në stërvitje rajonale në kuadër të iniciativës "Adrion", duke qenë edhe drejtuese e disa prej stërvitjeve të zhvilluara në këtë kuadër. Të gjithë këto angazhime tregojnë nivelin e lartë të profesionalizmit të personelit të Forcës Detare".

Operacion SAR nga anija P-134 "Butrinti"

Pas marrjes së informacionit nga Qendra e Vëzhgimit Detar, të cilët njoftuan për marrjen e një sinjali nga një mjet peshkimi skaf, që ndodhej në rrezik. Mjeti tip skaf, me emër "Luna 1999", që ndodhej 8 milje në perëndim të gjirit të Dafinës, kishte pësuar defekt në motor dhe rrezikonte lundrueshmërinë dhe jetën e dy personave që ndodheshin në mjet. Menjëherë pas njoftimit u aktivizua sistemi SAR nga anija e gatshme P - 134 "Butrinti" që ndodhej në rajon.

Si pasojë e veprimeve të sakta të efektivave të anijes së gatshme, u organizua operacioni i kërkim-shpëtimit dhe u përcaktua shpejt vendndodhja e mjetit në rrezik, duke i dhënë ndihmë në kohën e duhur.



Vizita e anijes britanike "RFA MOUNTS BAY" në radë, në Gjirin e Durrësit

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, anija britanike "RFA MOUNTS BAY" vizitoi gjirin e Durrësit.

Kjo anije është një anije ndihmuese e Forcës Detare Britanike, e cila shërben për operacionet e zbarkimit të mjeteve amfibe. Nga ana e Forcës Detare Shqiptare u morën të gjitha masat e nevojshme për pritjen e kësaj anijeje dhe koordinimin e të gjithë aktivitetit të saj në vendin tonë.

Për këtë qëllim Forca Detare angazhoi dy anije, anijen P-133 "LISSUS" dhe anijen P-04 "SEM-ANI" të cilat realizuan pritjen, shoqërimin e anijes për në vendin e qëndrimit në spirancë, transportin e personelit VIP si edhe personelit ushtarak, të cilët



kryen vizita në anijen Britanike. Kjo vizitë ofron një mundësi të shkëlqyer për të zhvilluar më tej lidhjet e forta midis Shqipërisë

dhe Mbretërisë së Bashkuar, veçanërisht këtë vit që shënon 100-vjetorin e marrëdhënieve midis dy vendeve.

Atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, vizitë në Forcën Detare

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një takim në Komandën e Forcës Detare atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Timothy Wight - Boycott. Qëllimi i takimit ishte njohja me angazhimet dhe planet e modernizimit të Forcës Detare, si dhe mundësitë e bashkëpunimit dypalësh për vitin 2023.

Komandanti i Forcës Detare njohu atasheun britanik me angazhimet e Forcës Detare për vitin 2023 në misionet jashtë vendit, si dhe ecurinë e projekteve të modernizimit. Gjithashtu gjatë takimit komandanti i Forcës Detare theksoi rëndësinë e trajnimit dhe edukimit të oficerëve të Forcës Detare në Britaninë e Madhe dhe se njohuritë e fituara kanë shërbyer në rritjen e profesionalizimit gjatë kryerjes së detyrave në anije.

Gjatë takimit, më gjatë u diskutua vijimi më tej i bashkëpunimit me palën angleze në fushën e edukimit dhe trajnimit për personelin e Forcës



Detare, në veçanti trajnimi i personelit të Qendrës së Zhytjes, për përdorimin e pajisjeve në operacionet për kërkimin e minave.

Në përfundim të takimit atasheu britanik, nënkolonel Timothy Wight – Boycott falënderoi për mikpritjen dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm midis dy forcave detare.

Kapiten lejtënant Lorenc Demiri - Honor Graduate në kursin Ndërkombëtar të Oficerit të Detarisë (IMOC) ndërmjet 28 oficerëve nga 21 vende të botës.

15 javë kurs me tematika Kërkim-Shpëtimi, Ligjshmëri, Konflikti i armatosur, Bording, Lider-ship, Inspektim Detar, Mbrojtje e mjedisit Detar, operacione të zbatimit të ligjshmërisë.

Kjo është hera e parë që një përfaqësues i FA-së arrin këto rezultate dhe përzgjidhet Oficeri më i mirë, bazuar në programin Akademik, iniciativë, diskutime në panele dhe prezantime të tematikave të ndryshme. Flamuri ynë Kombëtar nga tani e tutje do të valëvitet në këndin e nderit.



Komandanti i Forcave Detare të Republikës së Rumanisë zhvilloi një vizitë në Komandën e Forcës Detare

Në zbatim të planit të bashkëpunimit ushtarak me Republikën e Rumanisë, komandanti i Forcës Detare të Rumanisë, kundëradmiral Mihai Panait zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte rritja e bashkëpunimit dypalësh ushtarak midis forcave detare të dy vendeve dhe vlerësimi i mundësive për shtimin e bashkëpunimit të mëtejshëm në fusha me interes të përbashkët, si trajnime dhe stërvitje.

Kundëradmiral Panait dhe ekipi i tij zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, i cili u prit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra.

Gjatë takimit u diskutua ecuria e bashkëpunimit të deritanishëm midis dy forcave, si ai dypalësh, ashtu dhe në kuadër të Aleancës. Ushtarakët e dy vendeve vlerësuan vizitat portuale të anijeve rumune në vendin tonë dhe shkëmbimin e përvojës dypalëshe.

Në vijim të vizitës në Forcën Detare, kundëradmiral Mihai Panait zhvilloi një vizitë në ambientet e QNOD (Qendra e Vëzhgimit Detar), në të cilën u njoh me strukturën dhe organizimin e saj.

Kundëradmiral Panait, u prit në një vizitë kortezie dhe nga shefi Shtabit



të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, gjithashtu zhvilloi një vizitë në Akademinë e Forcave të Armatosura, gjatë së cilës u diskutua për krijimin e urave lidhëse midis AFA-së dhe Akademisë së Forcave

të Armatosura të Rumanisë.

Ndërsa vlerësoi nivelin e detarëve tanë, kundëradmiral Mihai Panait falënderoi komandantin e Forcës Detare për mikpritjen e treguar gjatë vizitës së tij tre ditore në Shqipëri.

Zhvillohet stërvitja operationale në ujëra të cekëta

Në Qendrën e Zhytjes Pashaliman u zhvillua një stërvitje e përbashkët ndërmjet Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare shqiptare në bashkëpunim me 13 efektivë, pjesë e "Delta 2" nga Britania e Madhe.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje të përbashkët është standardizimi i procedurave, rritja e kapaciteteve operationale të Qendrës së Zhytjes në operatione kundër-minë në ujëra të cekëta, koordinimi i veprimeve nënujore në operationet e përbashkëta EOD/IED në kushte dhe pamje të kufizuar, gjithashtu dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet vendeve anëtare të NATO, si dhe shkëmbimin e eksperiencave midis pjesëmarrësve.

Stërvitja u ndoq dhe nga zëvendës ambasadorja britanike Camilla Morouk, zëvendës atasheu britanik, major Imam Ahson, zëvendës-komandanti i Forcës Detare si dhe komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman.



Batalioni i Xhenios i uron mirëseardhjen në atdhe Kontingjentit XI EOD

Në mjediset e Batalionit të Xhenios është zhvilluar ceremonia e ardhjes së Kontingjentit XI EOD nga Letonia.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, si dhe komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhillaj. Kolonel Mëhillaj falënderoi gjeneralin për praninë e tij në këtë ceremoni si dhe shprehu mirënjohje për punën e bërë nga efektivit i Kontingjentit XI.

Gjeneral brigade Xhebexhia u uroi efektivave EOD mirëseardhjen dhe i përgëzoi ata për kontributin e çmuar të dhënë në misionin e Prezencës së Përfortuar të NATO-s (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s në Letoni, si pjesë e kontributit të FA-së në përbërje të Aleancës.

Ai vuri në dukje punën, përkushtimin e profesionalizmin e treguar në realizimin me sukses të detyrës jashtë vendit si dhe i siguroi të pranishmit për mbështetjen që do të kenë nga Komanda Mbështetëse në realizimin e detyrave të ndryshme.



Kompania EOD e Komandës Mbështetëse, një kapacitet mbështetës për eliminimin e rrezeqeve nga municionet dhe eksplozivët

Shërbimi i asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve (EOD) është një kapacitet kombëtar mbështetës, që redukton dhe eliminon rrezikun që vjen nga municionet dhe eksplozivët që kërcënojnë personelin, instalimet ushtarake, popullsinë e pronën, si brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të operacioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Qëllimi është krijimi i Qendrës së Ekselencës për EOD dhe Armatim-Municionin për të gjithë rajonin, nëpërmjet zhvillimit të kurseve të të gjitha niveleve, me ndihmën dhe bashkëpunimin e partnerëve tanë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kontingjente të EOD-së të Komandës Mbështetëse, prej vitesh kanë dhënë kontribut në misione të ndryshme ndërkombëtare dhe aktualisht janë pjesë e misionit të NATO-s "Enhanced Forward Presence" në Letoni. (NATO enhanced Forward Presence Battle Group Latvia).



KTHOSH, vizitë në Vaun e Dejës

Në vijim të programit mësimor për vitin akademik 2022-2023 kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, zhvilluan vizitë njohëse në batalionin e parë të këmbësorisë së Forcës Tokësore, Vau i Dejës, Shkodër. Kjo vizitë u zhvillua si pjesë e programit të Departamentit të Operacioneve Ushtarake me qëllim njohjen e kursantëve me strukturat e Forcave tona të Armatosura, duke realizuar një ndërthurje midis anës teorike dhe asaj praktike. Stafit akademik dhe kursantët u mirëpritën nga nënkolonel Ali Mali, i cili, pasi i falënderoi për vizitën, evidentoit rëndësinë e këtij kursi për karrierën ushtarake, por edhe në rritjen e nivelit profesional për përmbytjen në praktikë të detyrave nga oficerët me gradën "major" në të ardhmen. Më pas në brifingun e prezantuar, kursantët u njohën në veçanti me kontributin që jep ky batalion në operacionet brenda dhe jashtë vendit. Kursantët treguan mjaft interes dhe drejtuan pyetje mbi emergjencat civile, punën që bëhet për rritjen e nivelit të operacionalitetit, modernizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës. Në përfundim kursantët vizituan ambientet e kësaj njësie, ku panë nga afër infrastrukturën, pajisjet, masat për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Ndërtohet ura e re tip “Bailey” në fshatin Kabash, Bashkia Pukë

Specialistët e Kompanisë së Urave, të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, kanë realizuar me sukses ndërtimin e urës tip “bailey”, me gjatësi 30 m, seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 tonë. Kjo urë ka një rëndësi të veçantë, pasi është vijimi i rrugës prej 6 km, rrugë e hapur nga Bashkia dhe mundëson lidhjen e fshatit Kabash.

Ura i vjen në ndihmë 500 banorëve në fshatrat Kabash, Buhot, Meçe. Kjo urë gjithashtu bën lidhjen e kishës historike e njohur si Abacia e Shën Palit, objekt pelegrinazhi si dhe xhaminë shekullore të zonës dhe rrënojat e Kalasë së fshatit Kabash. Bën gjithashtu lidhjen e shtigjeve turistike që përshkojnë zonën, Pukë-Kabash-Krrabë.



Në Batalionin e Xhenios u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit të 12-të EOD në mision në Letoni

Në Batalionin e Xhenios të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit të 12-të EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (Enhanced Forward Presence eFP) të NATO-s, si pjesë e grup - batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze të dislokuara në Letoni. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia si dhe komandantët e reparteve. Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, ku gjatë fjalës së tij theksoi vlerat dhe aftësitë e spikatura nga eksperiencat e mëparshme të këtij misioni dhe shprehu besimin se edhe ky angazhim do të përballohet me sukses, për t'i shërbyer rritjes ndërvepruese e bashkëpunuese sipas procedurave të NATO-s.

Rëndësia e këtij kontributi në shërbim të paqes së përbashkët përkrah aleatëve tanë të Aleancës dhe vijimësinë e tij nëpërmjet këtij



kontingjenti, ka arritur një standard të lartë gjatë kontributit të tij në misionin e FP të NATO-s në Letoni.

Më tej ceremonia vazhdoi

me dorëzimin e flamurit për kontingjentin e 12-të EOD. Në fund ceremonia u mbyll me foton e përbashkët.



Studentë të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë kontribuojnë në vlerë monetare në disa familje në nevojë të qytetit të Vlorës

Në kuadër të festave të fund-vitit, studentët dhe kadetët e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë kanë ndërmarrë një nismë humanitare, së bashku edhe me përfshirjen e stafit të Grupit të Komandimit, për të ndihmuar disa familje në nevojë. Fakti se për gati 2 vite FMS ka shërbyer e dislokuar në qytetin e Vlorës, ishte edhe arsyeja përse studentët zgjodhën që kontributin e tyre në vlerë monetare ta dhuronin pikërisht në disa familje në nevojë të qytetit të Vlorës, në shenjë falënderimi për mbështetjen që iu është ofruar nga vendasit. Një grup përfaqësues i trupës studentore realizoi shpërndarjen e kontributeve.



Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve, u hap kursi i 52-të i Avancuar i Nënoficerit, i përbërë nga 55 kursantë, ku 6 prej tyre janë pjesëtarë të FSK-së.

Kursi zgjat gjithsej 8 javë dhe ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të rreshterit si drejtues në rol të zëvendëskomandantit të togës dhe detyrave të njehsuara me të teknikave të punës dhe ndihmës kryesor për stërvitjen e togës, si dhe në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe drejtuese.



Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të Kursit 75 Fill-estar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve, stafi i Komandantit, personel nga Dega e Administratës dhe Arsimit, si dhe stafi instruktorë dhe mësimdhënës.

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve, u hap Kursi 53 Bazë i Nënoficerit. Kursi Bazë ka si qëllim përgatitjen e kursantëve, si drejtues në rol të komandantit të skuadrës në specialitetin përkatës dhe zgjat 8 javë.



Baza Ajrore e Farkës, 55 vite fluturime humanitare, sakrificë, përgjegjësi

Baza Ajrore e Farkës është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1967. Zanafilla e kësaj baze është në vitin 1956, kur pilotë e teknikë shqiptarë u dërguan për t'u trajnuar në ish-Bashkimin Sovjetik në Rusi. Ndërsa në vitin 1957 u krijua njësi e parë e transportit ushtarak nr.5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa aeroplanë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandanti i njësisë u emërua Peço Polena, komandant i trios së parë të MI-4 u emërua Petrit Malindi.

Mersin Minxha u emërua komandant i treshes së dytë të MI-1, ndërsa Refit Jazo ishte komandanti i avionëve JAK-18.

Më 4 shtator 1957, u bë fluturimi i parë. Helikopteri i pilotuar nga Peço Polena fluturoi në segmentin Tiranë-Shkodër-Tiranë.

Në vitin 1967, rreth 30 helikopterë të rinj MI-4 të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës u përfshinë në këtë njësi. Kjo njësi u emërua "Regjimenti i parë i helikopterëve", më 6 dhjetor 1967, dhe komandanti i saj u emërua Lulo Musaj. Regjimenti përfshinte tre skuadron e helikopterëve MI-4, një makinë për riparimin e helikopterëve, pistën për heliport, duke lejuar ngritjen dhe uljen e njëkohshme të helikopterëve, kazermave dhe kushteve normale për personelin, rojet dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur detyra.

Baza Ajrore e Farkës ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e trajnimeve të ndryshme ushtarake të asaj kohe, por gjithashtu ka ndihmuar popullatën



në emergjenca civile, veçanërisht në rastet e përmytjeve, zonat malore të bllokuara nga bora, tërmetet apo edhe në kohë krizash. Kjo bazë gjithashtu ka ndihmuar në trajnime të ndryshme të Forcave Ajrore, ose ushtrime të përbashkëta me forcat e njësive të tjera të Forcave të Armatosura, duke treguar cilësi të lartë dhe nivel të trajnimit të fluturimit. Për të kryer misionin e saj, personeli i kësaj baze trajnohet intensivisht për të mbajtur në gatishmëri të vazhdueshme teknikën e ajrit, për të kryer detyra të tilla si: transportimi i trupave, operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR),

shpërndarja e ndihmës ushqimore ose transportimi i pacientëve në emergjenca civile. Në vitet e fundit, infrastruktura e bazës është përmirësuar ndjeshëm, kryesisht për shkak të asistencës së ofruar nga Ushtria Italiane. Hekuroporti i ri është ndërtuar me të gjitha pajisjet përkatëse për uljet dhe ngritjet ditore dhe të natës.

U rindërtuan kazermat, si dhe makineritë për mirëmbajtjen e helikopterëve; drejtimi dhe kulla e fluturimit është e pajisur me vegla moderne. Personeli i Bazës Ajrore të Farkës është kualifikuar për të përmbushur standardet dhe



misionin e saj.

Kjo bazë është një simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në stërvitje të përbashkëta, ku pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesionalizëm për të koordinuar veprimet për të përmbushur misionin.

Çdo vit kjo bazë mbart mbi 500 fluturime në operacione humanitare për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për transportin e të sëmurëve, kundër zjarreve, transportin e ndihmave humanitare, në mbështetje të komunitetit gjatë përmbytjeve, etj.

Shumica e personelit teknik

dhe pilot janë kualifikuar në shkollat dhe njësitë perëndimore si në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Disa prej drejtuesve të Bazës Ajrore të Farkës në vite janë: Lulo Musai, Refat Kasimati, Hetem Mehmeti, Sinan Çela, Enver Taho, Beqir Barxha, Raqi Qarri, Syrja Gjoka dhe Frederik Beltoja.

55-vjetori i krijimit e gjen Bazën Ajrore të Farkës në prag të modernizimit me helikopterët "Black Hawk", duke u bërë më operacionale edhe në misionet ndërkombëtare.

Në këtë 55-vjetor të Bazës

Ajrore Farkë, kujtohen me respekt të veçantë dhe vlerësim çdo përpjekje, kurajë, mundim dhe dërsë e derdhur ndër vite nga breza të tërë pilotësh, teknikësh, specialistësh, të cilët kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre në përmbushje të misionit dhe detyrave në shërbim të qytetarëve dhe vendit.

Kontributi i dhënë ndër vite nga ata është transmetuar sot edhe tek brezat e rinj, që evidentohet me pjesëmarrjen e tyre në Emergjencat Civile në ndihmë të komunitetit, stërvitjet e përbashkëta brenda dhe jashtë vendit.





55 vjet nga krijimi i ish-Regjimentit të Helikopterëve, Baza Ajrore Farkë

“Baza Ajrore, ashtu sikurse e gjithë Forca Ajrore, ka në natyrën e shërbimit të saj nevojën dhe sfidën e vazhdueshme për t’u zhvilluar dhe modernizuar, por edhe për t’u transformuar në përgjigje të kërkesave të reja dhe standardeve bashkëkohore”.

Në mjediset e Bazës Ajrore Farkë është kremtuar 55-vjetori i krijimit të ish-Regjimentit të Helikopterëve, sot Baza Ajrore Farkë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Manushaqe Shehu, veteranët e aviacionit, të ftuar nga pushteti lokal dhe ushtarakë të Forcës Ajrore.

Komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Pulaj në fjalën e rastit u shpreh: “Që nga krijimi e në vazhdim kjo bazë ka dhënë një kontribut të shquar në realizimin e misionëve të ndryshme ushtarake dhe civile, ka zhvilluar stërvitje të përbashkëta me ushtritë e ndryshme të rajonit dhe ka ndihmuar komunitetin në zona malore të zëna nga dëbora, në operacionet për tërmetet, si dhe në krizën e kosovarëve në vitin 1999. Reformimi dhe modernizimi i Forcës Ajrore dhe Bazës Ajrore Farkë, me mjete dhe teknologji perëndimore të gjeneratave të

fundit, është një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Së shpejti ne presim kompletimin me helikopterë të tipit “Black Hawk”, për të cilët kemi filluar përgatitjen profesionale dhe trajnimin e personelit që do të shërbejë në këto helikopterë.”

Në fjalën e saj përshëndetëse me rastin e 55-vjetorit të krijimit të ish-Regjimentit të Helikopterëve, Farkë gjeneralmajor Shehu shprehu se: “Baza Ajrore, ashtu sikurse e gjithë Forca Ajrore, ka në natyrën e shërbimit të saj nevojën dhe sfidën e vazhdueshme për t’u zhvilluar dhe modernizuar, por edhe për t’u transformuar në përgjigje të kërkesave të reja dhe standardeve bashkëkohore.” Në emër të veteranëve të aviacionit, fjalën përshëndetëse e mbajti, z. Sami Guzina, i cili foli për historikun e kësaj baze dhe vlerësoi punën e palodhur të shumë brezave që kanë punuar në Regjimentin e Helikopterëve. Aktiviteti u mbyll me shpërndarjen e “Certifikatave të Mirënjohjes”, për personelin që kanë punuar në këtë bazë dhe sapo kanë dalë në pension, si dhe dhënien e “Medaljes së Pilotit”, për disa pilotë të kësaj baze.



Pas rreth 8 javësh programi arsimor në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, janë certifikuar sot me sukses 25 kursantë të Kursit të Avancuar të Nënoficerit, në specialitetet “këmbësori” dhe “artileri tokësore”.



Në batalionin e Tretë të Këmbësisë vijon përgatitja e kontingjentit për dislokim në kuadër të misionit “KFOR” në Kosovë.



SEEBRIG, vizitë vlerësuese në Forcën Tokësore

Një ekip i Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), i kryesuar nga komandanti i kësaj njësie gjeneral brigade Evangelos Mitrou-tisikos, zhvilloi një vizitë vlerësuese në Forcën Tokësore (FT).

Fillimisht, ekipi u prit në një takim të veçantë nga zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Ferdinand Dima dhe Shtabi i Forcës Tokësore.

Në takimin me palën e SEEBRIG, gjeneral brigade Dima, vlerësoi rolin që luan kjo brigade multinacionale në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në Evropën Juglindore, ku vendi ynë përfaqësohet me oficerë në shtab si dhe me disa nënrepartete të deklaruar si pjesë e saj. Gjeneral brigade Mitrou-tisikos, falënderoi gjeneral brigade Dimon për pritjen e ngrohtë dhe vlerësoi me nota pozitive profesionalizmin e ushtarakëve shqiptarë, që janë pjesë e brigadës së SEEBRIG, duke shprehur besimin se gjatë vizitës vlerësuese, do të gjejë të njëjtin nivel përgatitje edhe tek efektivat e nënreparteteve të deklaruar nga vendi ynë, si pjesë e Brigadës së Evropës Juglindore.

Më tej, takimi vijoi me një prezantim të mbajtur nga shefi i Degës së Planifikimit në Forcën Tokësore, kolonel Agim Shahu, ku ekipi i inspektimit u njoh me misionin, detyrat, dhe aktivitetet kryesore të Forcës Tokësore gjatë vitit 2022. Në një tjetër prezantim, për të pranishmit, kapiten Bekim Kuçana, komandanti i Kompanisë I të b2k dha një informacion të detajuar mbi aktivitetin e nënrepartit që ai drejton, strukturë kjo e deklaruar si pjesë e SEEBRIG.

Vizita vijoi me inspektimin në terren të personelit të Kompanisë I të Batalionit të Dytë të Këmbësisë si dhe me inspektimin e Kompanisë së Xhenios së Batalionit të Mbështetjes më Luftim, nënrepartete këto të deklaruar si pjesë e SEEBRIG.



Në këto inspektime, ekipi i SEEBRIG, u fokusua në çështjet e personelit, organizimit/mbështetjes shëndetësore, operacioneve, komunikimit, xhenios etj. Gjatë vizitës vlerësuese të ekipit të SEEBRIG,

efektivët e kompanisë I të b2k dhe ata të xhenios së bML, zhvilluan demonstrime nga programet e tyre stërvitore. Vendi ynë është pjesë e SEEBRIG, prej shtatorit të vitit 1998.





Forca Tokësore rrit kontributin e saj në kuadër të paqes dhe sigurisë, me nisjen e kontingjentit të parë si pjesë e operacionit “Aktiviteti i vigjilencës së përforcuar”, e drejtuar nga NATO në Bullgari. 30 efektivë të batalionit të Parë të Këmbësorisë (b1k) do të bashkohen me trupat aleate në Novo Selo, Bullgari, ku do të shërbejnë për një periudhë rreth 6-mujore.



“ALB-ITA MLF/EUBG Expert meeting”, aktiviteti i organizuar në Forcën Tokësore në nivel ekspertësh, i cili synonte zhvillimin e bisedimeve për përfshirjen e efektivëve të Forcës Tokësore, në kornizën e Forcës Tokësore Shumëkombëshe dhe Grup Batalionit European (MFL/EUBG).



INTERVISTË ME KOMANDANTIN E FORCËS DETARE, KUNDËRADMIRAL ADNAND AGASTRA

Forca Detare, 97 vjet lundrim nëpër histori suksesi

INTERVISTOI
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

"Kur të shkruhet historia e lundrimit botëror, ujërat e brendshme të Shqipërisë do të japin material shumë interesant, që u përket kohërave më të lashta të historisë së lundrimit..."

E rëndësishme dhe historike fuqia e këtij aseti të Ushtrisë Shqiptare, rrugëtimi i së cilës na bën krenar.

Në prag të shekullimit të tij vjen e transformuar dhe me sfida të reja drejt së ardhmes.

Komandant i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, me një eksperiencë të gjatë në fushën e mbrojtjes dhe me një formim të gjerë akademik, në një intervistë për shtypin ushtarak sjell zhvillimet dhe risitë e një prej forcave elitare të Forcave të Armatosura.

Kur është krijuar Forca Detare?

Forca Detare është krijuar, më 25 dhjetor 1925, por traditat detare të popullit tonë janë po aq të lashta sa vetë historia e tij. Këtë traditë e trashëgojmë që nga flota e famshme e mbretit Bardhyl dhe mbretërreshës Teuta, që përballuan tre luftëra me flotën romake, tek kapedanët e famshëm ulqinakas e arvanitas, tek krijuesit e flotës detare të shtetit të parë shqiptar, deri te arkitekti dhe ndërtuesi i Flotës Luftarake Detare, kundëradmiral Abdi Mati. Historia moderne e Forcës Detare daton më 25 dhjetor 1925, kur një grup marinësh nën drejtimin e Ahmet Kapedanit valëviten flamurin shqiptar në ujërat tona territoriale. Anijet "Shqiponja" dhe "Skënderbeg" dhanë sinjalin e parë të patrullimit të Forcës Detare, në emër të ruajtjes së kufirit detar të shtetit shqiptar.

Lufta e dytë botërore shkatërroi plotësisht Flotën Detare. Pas çlirimit të vendit, më 15 gusht 1945, u krijua Flota Luftarake Detare. Vitet 50 zhvilluan një etapë të re për zhvillimin e FD-së, e cila u pajis me katra silurues, dragamina, gjuajtës detar, anije ndihmuese e më pas edhe me 4 nëndetëse, ku u pajis me mjetet më moderne të kohës nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe me vonë me mjete nga Kina.



**Komandant i Forcës Detare,
kundëradmiral Adnand Agastra**

Cili ka qenë misioni, detyrat dhe struktura organizative e saj?

Forca Detare në varësi të kohës ka pasur detyra të ndryshme, por ajo që nuk ka ndryshuar asnjëherë, është misioni i cili ka qenë dhe është aktual dhe sot. Përveç misionit tradicional të pandryshuar të Forcës Detare "Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura", me nevojat që kishte vendi ynë në periudhën pas viteve 90, në vitin 2002 i është shtuar edhe misioni dhe detyrat

e Rojës Bregdetare. Misioni aktual është: "Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimi i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëveprim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare".

Detyrat Kryesore të Forcës Detare janë:

- Të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues.
- Të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA-së dhe të NATO-s në drejtimet e kërcënuara.
- Monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.
- Organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkimshpëtimit (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA-së.
- Të ruajë dhe të mbrojë mjedisin detar për zbatimin e ligjshmërisë në det.
- Sigurimi i kushteve hidro-lundrimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH-së.
- Të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve.
- Të marrë pjesë në përballimin e rreziqeve asimetrike të terrorizmit, krimit të organizuar në bashkëveprim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.

Forca Detare (FD) përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i FD-së, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Flotila Detare e cila është reparti kryesor, Qendra e Vëzhgimit Detar, Shërbimi Hidrografik, Qendra e Zhytjes dhe Qendra Stërvitore Bazë Detare.

Çfarë ofron arsimimi dhe stërvitja në Forcën Detare?

Arsimimi ushtarak për detarët është pjesë integrale e arsimit të lartë të ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Rritja e profesionalizmit, ndërveprimit dhe operacionalitetit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), vijimi i transformimit, modernizimit, përmbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës, rritja e gatishmërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për garantimin e sigurisë dhe përballimin e të gjithë skenarëve të kërcënimeve kërkon një qasje të re në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor dhe një trajnim individual të personelit për ta bërë atë sa më cilësor dhe fleksibël. Aktualisht nuk ka një Akademi Detarie, e cila për shkak të nevojave të reduktuara për personel nuk ishte e nevojshme për të mbajtur një Akademi Ushtarak Detare.

Përveç rekrutimit të oficerëve nga akademitë detare të vendeve të tjera, rekrutohen edhe oficerë nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe degët e navigacionit

të universiteteve tona.

Qendra Stërvitore Bazë e Forcës Detare merret me trajnimin në specialitetet përkatëse të personelit nga detar, nënoficerë dhe oficerë sipas kriterëve funksionale. Gjithashtu Qendra Stërvitore Bazë kryen dhe trajnime për institucione të tjera të RSH-së si Policia Kufitare.

Procesi i arsimit të personelit të FD-së është një sistem i konsoliduar në përputhje me standardet e NATO-s, ku ka si objekt kryesor përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale si dhe një sistem i unifikuar dhe standardizuar, në përputhje me nevojat dhe detyrimet që shtrohen përpara një force anëtare të NATO-s.

Cilat janë programet arsimore dhe stërvitore?

Forca Detare si strukturë përgjegjëse për përgatitjen në specialitetet detare të personelit të saj ka Qendrën Stërvitore, në të cilën zhvillohen programet arsimore të specialiteteve detari, të cilat janë pjesë e vijimësisë së kurrikulave të Akademisë së FA-së të akredituara nga Ministria e Arsimit. Disa prej kurseve funksionale që ofrohen nga kjo strukturë janë:

Kursi Bazë i Oficerit të Marinës, Kursi në specialitetin "Bocman-Sinjalist", Kursi në specialitetin "Motorist-Elektricitist dhe jetëgjatësia në anije", Kursi "SAR & Bording", Kursi në specialitetin "Sistemet e armatimit në anije", Kursi në specialitetin e ligjshmërisë detare, etj.

Në bashkëpunim me Qendrën e Zhytjeve, Qendra Stërvitore Bazë organizon edhe Kursin Bazë të Zhytjes, i cili është një kurs në nivel kombëtar, ku përgatiten dhe forcat Speciale të FARSH-së dhe ato RENEA të Policisë së Shtetit.

Çfarë synohet të arrihet mes tyre?

Me zhvillimin e këtyre kurseve, trajnimeve dhe stërvitjeve mundësohet përgatitja e personelit të FD-së në aftësimin profesional dhe fizik në interes të realizimit të misionit dhe detyrave.

A është në standardin e duhur arsimimi ushtarak profesional i Forcës Detare, për t'i shërbyer realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë? Po me atë të shkollave të vendeve të NATO-s?

Ashtu siç përmenda edhe më lart, arsimimi ushtarak për detarët është pjesë integrale e arsimit të lartë të ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë në Akademinë e Forcave të Armatosura të akredituara nga Ministria e Arsimit. Kurset dhe trajnimet e ofruara nga Institucionet përkatëse të FA-së dhe të FD-së që janë në përputhje me kërkesat e kohës dhe të realiteteve të mjedisit të ri të sigurisë ku personeli zhvillohet dhe trajnohet sipas standardeve të NATO-s.

Duke qenë se jemi vend anëtar i NATO-s, arsimimi ushtarak ka njësim me dokumentacionin dhe librat e stërvitjes që operohet nga të gjithë vendet e Aleancës, në këtë mënyrë mund të themi se, po, kemi arsimimin e duhur megjithëse duhet punë, pasi arsimimi është një fushë që e ndjek ushtarakun gjatë gjithë karrierës së tij. Pavarësisht trajnimeve që



kryejmë në FARSH shumë nga trajnimet dhe kurset, efektivat tanë kanë mundësi t'i kryejnë edhe në vende partnere të NATO-s.

Cilat janë disa prej stërvitjeve më të rëndësishme të FD-së?

A disponojmë ne burime njerëzore dhe logjistike si ato të 'simotrave' tona të aleancës së NATO-s, pjesë e së cilës jemi dhe ne?

Në aktivitetin e saj, kryesisht pas viteve '90, FD ka zhvilluar si dhe ka marrë pjesë në shumë stërvitje bilaterale si dhe multilaterale, në kuadër të Aleancës si dhe në atë rajonal. Një stërvitje me pjesëmarrjen e disa shteteve anëtare të NATO-s ishte ajo e vitit 2005 COOPERATIVE ENGAGEMENT, ku FD kishte rolin bashkëdrejtues si dhe stërvitja u zhvillua në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë. FD është aktive në iniciativën ADRIAN, e cila që prej vitit 2006 vazhdon stërvitjet praktike LIVEX, stërvitje që zhvillohet me rotacion, ku çdo vit vendi organizator është njëri nga shtetet anëtare të Iniciativës. Që nga viti i anëtarësimit në Iniciativën ADRIAN, vendi ynë ka qenë 3 herë vendi organizator i kësaj stërvitjeje. Përtej tyre në mënyrë të vazhdueshme FD ka zhvilluar stërvitje si në ujërat tona territoriale por dhe në ujëra ndërkombëtare, stërvitje me vende si SHBA-të, Angli, Francë, Itali etj. Këto stërvitje kanë bërë të mundur që efektivat jo vetëm të aftësohen dhe të ngrihen profesionalisht por dhe të ndërveprojnë me anijet e NATO-s me detyrat dhe nevojat qofshin ato kombëtare apo nevoja rajonale si dhe të NATO-s. Është e njohur nga të gjithë stërvitja e NATO-s "DEFENDER EUROPE 2022", e cila pat një përfshirje nga të gjithë FARSH-të, ku FD kishte rolin kryesor në sigurimin dhe mbështetjen në stërvitjen. Një stërvitje shumë e veçantë është stërvitja bilaterale, e cila u zhvillua me SHBA-të me anijet e Flotës së 6-të të Paqësorit, ku për herë të parë FD zhvilloi qitje me anijet amerikane GUNEX. Të gjitha këto stërvitje bëjnë të mundur aftësimin e efektivave si dhe mundësinë e tyre që të ndërveprojnë me vendet e Aleancës, pasi stërvitjet

zhvillohet sipas procedurave standarde të standardizuara nga vendet aleate të NATO-s. Gjithashtu Forca Detare periodikisht merr pjesë me personel ose dhe me anije në stërvitjet ndërkombëtare që zhvillohen nga NATO në vende të ndryshme të rajonit. Si të tilla mund të përmenden pjesëmarrja në stërvitjet "Mare Aperto" në Itali, "NIIRIS" në Greqi, "BREEZE" në Bullgari dhe "SEA SHIELD" në Rumani, etj.

Cilat janë disa prej arritjeve të 10-vjeçarit të fundit të Forcave Detare?

FD/Roja Bregdetare është një kapacitet aktiv i FARSH-së me angazhimin e saj 24/7. Për shkak të kësaj domosdoshmërie FD stërvitet, trajnohet, por dhe modernizohet, si rezultat i së cilës është edhe pajisja me 4 anije të reja të Klasit ILIRIA, një prej të cilave u ndërtua nga Kompania "DAMEN Shipyards" në Holandë, ndërsa 3 të tjerat u ndërtuan në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në Pashaliman, Vlorë. Gjithashtu ngritja e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) të RSH-së, me kompaninë amerikane "Lockhead Martin" siguron kapacitete vëzhguese dhe monitoruese të hapësirës detare, duke u ofruar këtë shërbim edhe institucioneve të tjera me interesa në det.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera ligj zbatuese ka sjellë uljen e aktivitetit të jashtëligjshme si dhe garantimin e ujërave tona për një lundrim të sigurt. Si një nga arritjet e Forcës Detare në këtë 10-vjeçar mund të përmendim pjesëmarrjen për tre vjet rresht me anije dhe personel në Aktivitetin e NATO-s në Detin Egje, pjesë e operacionit të NATO-s "Sea Guardian", ku detyra kryesore ishte kontrolli dhe ndalimi emigracionit të paligjshëm që vinte si rezultat i luftës në Siri si dhe shpëtimi i emigrantëve që u rrezikohej jeta në det. Gjatë pjesëmarrjes në këtë operacion anijet e Forcës Detare asistuan dhe morën pjesë në shpëtimin e rreth 3 000 emigrantëve të paligjshëm që u rrezikohej jeta në det. Forca Detare mori pjesë për herë të parë në një op-

eracion të drejtuar nga NATO, i cili për herë të parë në FA u mbështet plotësisht nga Forca Detare. Pjesëmarrja në këtë operacion të Forcës Detare u vlerësua maksimalisht nga NATO dhe pavarësisht faktit të sasisë së limituar të kapaciteteve të vendit tonë, përsëri u arrit angazhimi me efikasitet në përballimin e kësaj detyre. Ky lloj angazhimi kërkonte jo vetëm pajisje dhe teknikë por edhe një trajnim dhe stërvitje të mirë të personelit për të përballuar vështirësitë që sjellin kushtet atmosferike dhe deti. Ky angazhim u arrit edhe në sajë të besimit që kishte Ministria e Mbrojtjes, SHPPFA dhe vetë Forca Detare në personelin e saj, se ky angazhim do të përmbushej me sukses.

Ambicia e Forcës Detare vijon të rritet mbi bazën e vlerësimit të mundësive tekniko-financiare, por dhe mbi besueshmërinë që kemi në përgatitjen e efektivave. Këtë vit, Forca Detare ka deklaruar pjesëmarrjen në dy operacione të NATO-s për vitin 2023: Rikthehemi në Aktivitetin e NATO-s në Detin Egje si dhe për herë të parë do të marrim pjesë në operacionin e NATO-s, FOCOPS, që ka të bëjë me grumbullimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit gjatë patrullimit në hapësirën e caktuar detare për sigurinë detare të Aleancës.

Duhet theksuar se viti 2022 ka qenë një sukses jo vetëm për Forcën Detare por edhe për shtetin Shqiptar, pasi gjatë këtij viti u anëtarësua në dy organizata ndërkombëtare IHO (Organizata Ndërkombëtare e Hidrografisë) dhe IALA (Shoqata Ndërkombëtare e Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Fenerëve). Kjo arritje do të përmirësojë sigurinë hidro-lundrimore si dhe mundëson krijimin e standardeve ndërkombëtare në hapësirën tonë detare me qëllim lundrimin sa më të sigurt në këtë hapësirë.

A kanë të rinjtë shqiptarë dëshirë të bëhen pjesë e Forcave Detare? Çfarë benefitesh ofron kjo forcë?

Forca Detare përballet me të njëjtat sfida si ato të të gjithë Forcave të Armatosura. Rekrutimi i personelit të kualifikuar teknik është një problem edhe në vendet e tjera të NATO-s. Ka një rritje të të rinjve që dëshirojnë për të qenë pjesë e Forcave Detare por që nuk është e mjaftueshme. Duhet theksuar që ndryshe nga pjesa tjetër e Forcave të Armatosura, personeli i Forcës Detare ka specifika të veçanta, pasi puna në anije kërkon specialitete të tilla si navigacion, mekanikë, elektronikë dhe komunikim të cilat përveç se kërkojnë arsimimin e duhur profesional janë profesione edhe shumë të kërkuara në treg.

Cilat janë projektet më të rëndësishme në drejtim të modernizimit të sistemit të integruar të vëzhgimit

të hapësirës detare, dhe infrastrukturës së reparteve të FD-së?

Nga pikëpamja e ambicies që Forca Detare ka në vijim për rritjen e kapaciteteve, duke filluar nga viti 2023, projektet më të rëndësishme do të jenë: Kompletimi me një anije patrulluese me kapacitete të mirëfillta luftarake për luftën detare dhe kundërajrore. Për këtë projekt madhor ka filluar puna për hartimin e kërkesave operacionale dhe planifikimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin me sukses të këtij projekti. Një projekt tjetër i rëndësishëm është modernizimi i Qendrës së Zhytjes me kapacitete dhe pajisje të afta për skanimin e tabanit të detit me qëllim zbulimin dhe identifikimin e minave detare apo municioneve të mbetura. Gjithashtu projekt i rëndësishëm është edhe modernizimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), ku Forca Detare dhe NATO kanë koordinuar për specifikimet teknike të kërkesës operacionale për këtë sistem. Përveç këtyre projekteve madhore të cilat priten të përfundojnë në një periudhë afatshkurtër, në vëmendje janë edhe disa projekte të tjera të cilat përmirësojnë dhe rrisin kapacitetet e Forcës Detare. Si të tilla mund të përmendim kompletimin me 6 anije të reja patrulluese të mesme, të cilat do të zëvendësojnë disa nga anijet e vjetra që kanë përbushur kohën e përdorimit. Në planin afatgjatë një projekt tjetër është edhe kompletimi me një anije shumë-funksionale për Qendrën e Zhytjeve dhe Shërbimin Hidrografik.

Cila është sfida më e madhe e afërt e Forcës Detare?

Forca Detare jeton çdo ditë mes sfidave operacionale, teknike, të kompletimit me personel, të cilat deri tani i ka përballuar me sukses. Por ajo për të cilën Forca Detare po përgatitet është realizmi i Objektivave të Kapaciteteve nëpërmjet përbushjes me sukses të planeve të modernizimit. Anija me kapacitete të mirëfillta luftarake është objektivi madhor për të ardhmen e afërt por gjithashtu është një objektivi i domosdoshëm, jo vetëm për Forcën Detare por edhe për të gjithë kuadrin e Forcave të Armatosura. Kjo është një sfida jo vetëm në aspektin financiar por njëkohësisht edhe një sfida për kompletimin dhe trajnimin me personel, jo vetëm për shfrytëzimin teknik por edhe për përdorimin operacional të teknikës dhe sistemeve të armatimit të saj. Sigurisht duhet theksuar se në këtë rrugëtim të Forcës Detare kemi pasur mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe shpresojmë se ky proces i sapo filluar do të realizohet në bashkëpunim me të gjitha strukturat që kanë lidhje me finalizimin e këtij projekti.

Arsimimi ushtarak për detarët është pjesë integrale e arsimimit të lartë të ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Rritja e profesionalizmit, ndëreveprimit dhe operacionalitetit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), vijimi i transformimit, modernizimit, përbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës, rritja e gatishmërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për garantimin e sigurisë dhe përballimin e të gjithë skenarëve të kërcënimeve kërkon një qasje të re në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor dhe një trajnim individual të personelit për ta bërë atë sa më cilësor dhe fleksibël.

KONCEPTI STRATEGJIK NATO-2022

Sfidë për Proceset tona Planifikuese të Sigurisë dhe Mbrojtjes



Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj
Instituti i Kërkimit Shkencor Ushtarak

Aleatët e NATO-s ranë dakord për Konceptin e ri Strategjik në Samitin e Madridit, qershor 2022. Ata ranë dakord ta bëjnë këtë dokument që në Samitin e Brukselit, qershor 2021, dhe krijuan një udhërrëfyes nga Brukseli në Madrid. Çfarë viti ka qenë – tashmë njihet ajo, si lufta për pushtimin rus të Ukrainës. Nuk ishte gjë e pazakontë që strategjia të bëhet në kohë krize dhe herë pas here studiuesit i identifikojnë kohët, veçanërisht te efektet e krizave. Megjithatë, nuk është e lehtë por e vështirë t'i shpëtosh rëndësisë së luftës konvencionale në shkallë të gjerë në Europë, përgjatë kufijve lindor të NATO-s.

Studiuesit, me seriozitet dhe përgjegjësi janë mbledhur disa herë në seksion të veçantë në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara, "West Point", për të dhënë draftin fillestar të Konceptit të ri Strategjik NATO - 2022. Nga studimet rezulton se ata ishin një grup që përfshinte profesionistë të politikave nga NATO dhe vendet aleate, akademikë nga e gjithë bota, udhëheqës të lartë ushtarakë nga të dy anët e Atlantikut dhe pedagogë e kadetë të akademisë "West Point". Ata kanë prezantuar, si

kërkime akademike të fundit, ashtu edhe analiza të politikave që pasojnë, sintetizojnë, kritikojnë dhe zhvillojnë më tej atë kërkim dhe analizë.

Nisur nga përmbajtja, Koncepti është vizion politiko-strategjik, i cili bazohet në fuqinë efektive ushtarake. Prandaj, fokusi i tij kryesor është në identifikimin e parimeve, parametrave dhe udhëzimeve të nevojshme për zhvillimin e politikave të duhura, planifikimin strategjik-operacional, strukturën e forcës dhe aftësitë e saj. Kjo përfshin përmirësimin e ndarjes së barrës transatlantike dhe krijimin e një aleance më të ekuilibruar, të mundësojnë për të marrë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen kolektive, të jenë reagues e të besueshëm në raste të krizave dhe emergjencave.

Koncepti Strategjik 2022 bazohet në Axhendën e NATO-s 2030, që ajo të jetë më efektive nëpërmjet kohezionit më të madh politik; gatishmërisë, aftësisë dhe kapacitetit të përmirësuar të FA-ve aleate; qëndrueshmëria e rritur; ndarje më e drejtë e barrës; një marrëdhënie të përforcuar NATO-BE dhe me vendet partnere. Gatishmëria më e mirë e NATO-s për të përballuar kërcënimet që vijnë nga teknologjitë në zhvillim është gjithashtu thelbësore për Konceptin Strategjik 2022.

Thelbi dhe sfidat e NATO-s qëndrueshmëria e aleancës: Ruajtja e paqes, mbrojtja e njerëzve, i miratuar në samitin e NATO-s, të qershorit 2022, në Madrid, vendos tre synime kryesore për Aleancën: të jetë mjaftueshëm e fortë ushtarakisht, të jetë më e bashkuar politikisht dhe të adoptojë një qasje më të gjerë globale ndaj sigurisë dhe mbrojtjes.

Misioni i Konceptit Strategjik është të mbrojë territoret, pop-

ullsinë, vlerat dhe forcat e Aleancës. Ai ka pesë elementë thelbësorë: (1) mbrojtjen e vlerave tona, (2) forcimin e fuqisë ushtarake të NATO-s, (3) forcimin e shoqërive të Aleancës, (4) miratimin e një pikëpamjeje globale dhe (5) ruajtjen e Aleancës si lidhje institucionale jetike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut.

Puna shkencore ka treguar në thelb çështjet kryesore që duhet të merrnin parasysh prioritetet strategjike të NATO-s për dekadën e ardhshme. Në këtë kontekst, në Dokumentin e Konceptit gjejmë përgjigjet e pyetjeve: se çfarë është Koncepti Strategjik i NATO-s dhe, pse NATO e zhvilloi atë në vitin 2022? Sigurisht që dokumenti është i hapur dhe në dorën e shumëkujt, i cili çdo ditë nga ne studiohet, vlerësohet dhe na jep horizonte të gjera për perspektivën e sigurisë së vendit dhe jo vetëm.

Ndasitë, përçarjet dhe shkatërrimi po shihen si rreziku, sfida dhe kërcënim me të cilin Aleanca duhet të përballë përmes një mbrojtjeje, parandalimi dhe angazhimi. NATO do të ruajë ose rivendosë integritetin dhe sigurinë e zonës Euro-Atlantike në të gjitha rrethanat, duke përdorur forca dhe burime të tilla që mund të jenë të nevojshme, si pjesë që kombinon reagimin fleksibël dhe praninë. Ajo do t'i përshtatet më tej karakterit dhe sjelljes së luftës që ndryshon me shpejtësi, e cila tani shtrihet në një mozaik të luftës së informacionit, luftës kibernetike, luftës "konvencionale" gjithnjë e më e shpejtë (e njohur edhe si hip-erluftë, tej/mbi/energji, etj.) dhe luftës bërthamore. Megjithatë, edhe me një rritje të dukshme të aftësive dhe kapaciteteve ushtarake, forcat dhe burimet do të jenë gjithmonë të kufizuara në shtrirje, duke pa-

sur parasysh shkallën e sfidave të nënkuptuara në spektrin e plotë të misionit të NATO-s. Duhet të arrihet një ekuilibër midis ruajtjes së parandalimit dhe mbrojtjes së besueshme në krahun verior dhe lindor të Aleancës; angazhim efektiv të sigurisë rreth Mesdheut, Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore; sigurisë së Atlantikut të Veriut dhe të sigurisë së globale, të cilat janë jetike për funksionimin strategjik të saj.

Aleanca do të vazhdojë të kërkojë dialogun me Rusinë dhe të respektojë Aktin Themelues NATO-Rusi, edhe pse Rusia vazhdon të shkelë vlerat, parimet, besimin dhe angazhimet e përshkruara në dokumente të tjera të dakorduara, që mbështesin marrëdhëniet NATO-Rusi. Veprimet agresive të Rusisë dhe sjellja gjithnjë e më sfiduese e Bjellorusisë – e përforcuar nga aftësia ushtarake në rritje e Moskës – vazhdojnë të përbëjnë kërcënimin për sigurinë dhe mbrojtjen e aleatëve. Pushtimi i paligjshëm i Krimesë, destabilizimi dhe agresioni ndaj Ukrainës, mbështetja për separatistët dhe mohimi i aspiratës legjitime të Ukrainës për të zgjedhur aleancat e saj, janë pjesë e një politike më të gjerë të detyrimit kompleks strategjik me të cilin Aleanca duhet të përballet. Prania ushtarake në rritje e Rusisë në Bjellorusi dhe nxitja e mijëra emigrantëve të dëshpëruar drejt Polonisë tregojnë për një politikë të sjelljes rreth kufijve të Rusisë, të drejtuar nga Kremli, e krijuar për të minuar sigurinë dhe stabilitetin e aleatëve në rajon.

Modeli agresiv i Rusisë përforcohet nga aftësitë në rritje të projektimit të fuqisë së forcave të armatosura, të cilat janë krijuar për të kërcënuar krahun lindor të NATO-s dhe rajonin e Detit të Zi. Lufta në Ukrainë, stërvitjet e kombinuara me presionin e vazhdueshëm ushtarak në kufijtë lindorë dhe veriorë të Ukrainës, sugjerojnë se Moska tashmë është e përfshirë në një konflikt me synimin për të shtrirë në pjesën më të madhe të Evropës Lindore.

Ajo është e angazhuar në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e municioneve të avancuara, të cilat synojnë të krijojnë një avantazh të qartë ndaj NATO-s, në zonat

që Moska i konsideron jetike për interesat e saj, dhe në një kohë që forcat ruse mund të sjellin fuqi të mëdha. Deti Arktik, Svalbard, Kepi i Veriut dhe Finmark, shtetet baltike, Bjellorusia, Ukraina dhe rajoni i Detit të Zi janë të gjitha zona ku Rusia është aktive. Për NATO-n kjo është sfidë dhe duhet t'i përgjigjet kësaj sfide.

Terrorizmi sfidon rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke kërkuar të minojë demokracinë dhe stabilitetin në mbarë globin. Rrjedhimisht, terrorizmi duhet parë gjithashtu si një kërcënim parësor për Aleancën.

Koncepti Strategjik i NATO-s, i miratuar nga shtetet dhe qeveritë

sensus për të ndërmarrë hapa në Konceptin e ri Strategjik.

Koncepti Strategjik i NATO-s është afërsisht analog me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të SHBA-së – 2022 pasi ajo ofron udhëzime strategjike dhe politike të nivelit shumë të lartë, të cilave mund t'u drejtohen politikatat dhe planifikuesit ushtarakë të aleancës kur formulojnë politika në fusha kyçe, duke filluar nga përshtatja dhe zhvillimi i aftësive deri te trajnimet dhe stërvitjet me fokus të mësimave të nxjerra nga kërcënimet e sotme.

Përveç planifikimit të dy viteve të fundit, Koncepti Strategjik NATO-2022 pasqyron gjithashtu punën planifikuese të politikave



aleate, është marrëveshja e nivelit më të lartë, që përcakton drejtimin strategjik të Aleancës. Duke qenë se NATO është një organizatë e drejtuar nga konsensusi, çdo aleat është potencialisht një "lojtar i vetos". Koncepti Strategjik përshkruan qëllimin e NATO-s dhe detyrat e saj thelbësore. Dokumenti gjithashtu artikulon kuptimet e përbashkëta të aleatëve për mjedisin e sigurisë në të cilin ata veprojnë: sfidat, mundësitë dhe kërcënimet.

Veçojmë se, në kushtet e formatimit të Konceptit Strategjik të NATO-s, pushtimi i Ukrainës nga Rusia duket se ka rritur konsensusin për këtë të fundit dhe aleanca forcohet mbi atë kon-

dhe ushtarake, të cilat kërkojnë të ofrojnë përditësime strategjike të luftës në Ukrainë nga Rusia, vijon të zbatojë përshtatjet nga Deklarata e Samitit të Uellsit dhe që çojnë në një sërë dokumentesh, që me siguri pasqyrohen në konceptin strategjik. Së fundi, Konceptet Strategjike pasqyrojnë gjithashtu strategjitë kombëtare të aleatëve që bien dakord me to, duke bërë të mundur reflektimin e procesit të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes së vendit, me qasje më të drejtuar për dokumentet si Udhëzimet e Politikës për Sigurinë, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare apo Strategjinë Ushtarake, të cilat janë në momentin më të mirë për rishikimin e tyre.

“Nëse Shekspiri do të ishte grua, nuk do të kish patur kurrë kohë për t’u bërë një gjeni”



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gratë nuk e kanë pasur kurrë luksin e të pasurit mjaftueshëm kohë për veten. Nëse i hedh një sy rutinës ditore të disa prej artistëve më të mëdhenj të kohërave (shumica meshkuj) do të vësh shumë aspekte interesante. Gratë u jepnin kohën e nevojshme për të krijuar, shërbëtoret u sillnin rregullisht për të ngrënë e për të pirë ndërsa edukatoret i mbanin fëmijët sa më larg. Le të marrim rastin e Zigmund Frojdit. Gruaja e tij Marta, jo vetëm që i bënte gati ndërresat çdo mëngjes por edhe hidhte pastën në furçën e dhëmbëve. Kujdestarja e Prustit, Celeste, jo vetëm që e ushqente çdo ditë me brioshë dhe kafe, por ishte aty për të, sa herë kishte ai nevojë për të folur, disa herë kjo ndodhte për orë të tëra.

Bashkëshortja e Karl Marksit jetonte në mjerim bashkë me tre nga gjashtë fëmijët e mbetur ndërkohë që vetë ai kalonte ditët mbi libra në Muzeun Britanik. Kompozitori Gustav Mahler u martua me Almën, një kompozitore e re të cilën e urdhëroi të mos merrej më me art me argumentin se në familje kishte vend vetëm për një artist. Alma kishte një detyrë: të kujdesej që askush të mos bënte zhurmë në shtëpi. Me të mbaruar notin e mesditës, Gustavi i fishkëllente Almës duke e ftuar për një shëtitje, ndonëse këto të fundit bëheshin gjithmonë në heshtje sepse kompozitori ishte shumë i zënë në mendjen e tij. Alma ulej në lëndinë dhe priste deri sa Gustavi të mbaronte së kompozuari, gjithmonë në heshtje. Në ditarin e saj Alma shprehte dëshpërimin dhe nevojën e madhe që dikush të mendonte për të e ta ndihmonte të gjente vetveten. “Më duket se jam kthyer në një shërbëtores”, - rrëfente ajo.

Ndryshe nga artistët e lartpërmendur, gratë që

merreshin me krijimtari e kishin atë të kufizuar nga pritshmëritë dhe detyrat e shtëpisë. Shkrimet e Fransinë Prose ishin në varësi të momenteve kur fëmijët iknin dhe vinin nga shkolla. Alise Munro-së, fituese e çmimit Nobel për letërsinë në vitin 2013, i duhej të numëronte minutat përpara se të shkruante, të pastronte shtëpinë e të kujdesej për fëmijët. Maja Angelou-t i erdhi në majë të hundës dhe u largua nga shtëpia duke u strehuar në një dhomë modeste hoteli, ku arriti të dëgjonte mendimet e saj, të lexonte dhe të shkruante.

Me një sy të lirë dhe vesh të hapur mund të kuptosh që pjesa dërrmuese e librave, pikturave, muzikës, zbulimeve shkencore dhe filozofisë që kemi mësuar në shkolla, kanë si autorë meshkujt.

Me këto shembuj, nuk ka se si të mos arrish në konkluzionin se grave nuk u ka munguar kurrë talenti për të lënë gjurmë në botë me idetë dhe artin e tyre. Thjesht nuk kanë patur kohë! Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, koha e një gruaje është ndërprerë dhe fragmentizuar nga punët e shtëpisë dhe përkujdesja për fëmijët por edhe detyra të tjera me qëllimin e mbajtjes së lidhjeve të forta shoqërore dhe familjare.

Nëse krijimtaria kërkon kohë pa ndërprerje, kohë të cilën mund ta mbash nën kontroll apo gjatë të cilës mund të përqendrohesh pa e vlarë mendjen, atëherë kjo për gratë është një luks i mirëfilltë. Edhe nëse nuk do të ishte luks, një grua do të përshkruhej si egoiste në rast se do të kërkonte kaq shumë kohë për të krijuar sa një burrë.

Në kohët moderne, në krahasim me burrat, gratë shpenzojnë dyfishin e kohës duke bërë punë shtëpie e duke u kujdesur për fëmijët. Po të llogarisim këtu edhe kohën që gratë shpenzojnë në punë dhe karrierë, koha që ato kanë në dispozicion për veten është thuajse inekzistente. Burrat në punët e tyre kanë të gjithë kohën që u nevojitet për të krijuar, kërkuar, shkruar dhe publikuar, këtë kohë e marrin pa ndërprerje, sepse u duhet të bëjnë emër, të ecin përpara e të lënë gjurmë.

Studiues të ndryshëm kanë zbuluar se shumë gra dhe vajza ndihen se nuk i meritojnë sa meshkujt ato orët e pushimit gjatë të cilave mund t’i përkushtohen vetes.

Shumë syresh ndihet sikur u duhet të punojnë fort për pak kohë për veten. Por për fat të keq, lista e punëve është gjithnjë e më e gjatë dhe arrin të vrasë ëndrrat e një jete të tërë.

Të mendosh sa poezi, sa nota muzikore e sa vepra arti janë fshehur, zhdukur e fshirë nga faqja e dheut vetëm sepse një grua ishte më e zënë me punët e shtëpisë. Shkrimtarja Virxhinia Ulf gjithmonë ka shtruar pyetjen se çfarë do të ndodhte me Shekspirin nëse do të kish qenë një grua. "Nëse Shekspiri do të ishte grua, nuk do të kish patur kurrë kohë për t'u bërë një gjeni. Nuk do lejohej të shkonte në shkollë, do urdhërohej të qëndronte në kuzhinë, do martohej shumë i ri dhe do dhunohej", - shkruante Ulf.

Sipas saj, motra e shkrimtarit ishte shumë e talentuar por u çmend dhe u dëbua në një kasolle në pyll, ku u cilësua si shtrigë dhe më pas u vra. Kompozitori i famshëm Moxart i adhuronte veprat e motrës së tij Nanerl dhe u thurte lavde pa fund. Krijimtaritë e saj u zhdukën sapo Nanerl u martua me një burrë të cilin nuk e dashuronte aspak.

Sa mirë do të ishte nëse ne do të krijojmë një botë ku motrat e Shekspirit, Moxartit ose çdo grua tjetër të arrijë të lulëzojë pa thundrën e një mashkulli. Çfarë do të ndodhte nëse gratë vendosin se nuk duan të kalojnë ditët duke marrë pluhurat e shtruar tavolinën?

Çfarë do të ndodhte nëse një grua vendos të marrë më shumë kohë për veten, të shpaloste të vërtetat e saj të pathëna e të ushqente veten që në qelizë?

Përpikuni ta imagjinoni!

Historisë kulturore shqiptare thellësisht të dominuar nga burrat i mungon një gjysmë.

Historia e femrës shqiptare nuk u shkrua, ajo gati nuk ekzistonte si subjekt, historitë e saj mbetën të parrëfyera, vuajtja e saj e pashlyer. Sigurisht gjen aty episode të romantizuara apo heroína novelash e romanësh, të formësuar sipas midesë së krijuesit, njolla e bardhë në histori mbetet, humbja nuk rikuperohet më.

Kur ecni nëpër qytete e shikoni emrat e rrugëve... sa rrugë mbajnë emra femrash të nderuara?

Padrejtësi, mëkat historik

Zëri i saj nuk u mbeti në kujtesën e historisë, u injorua, thjesht se nuk ishte zë burri. Ajo ishte më e mira, vetëm kur sakrifikohej e heshtur. Gruas i shkon buzëqeshja e butë, jo ngritja e zërit dhe revolta. Më saktë ky është krimi më i madh që kreu patriarkalizmi shqiptar në shekuj. Femra është viktima e tij e gdhendur në kujtesën e prapambetjes. Ai ia mbylli gojën, i vuri brezin e virgjinitetit, ia hoqi të drejtën e vetëvendosjes, ia preu rrugët e zhvillimit, duke e privuar me shekuj nga arsimimi e dija, duke e kthyer në makinë lindjeje.

Në kujtesën historike ka hyrë edhe një Teutë, por ajo është alibi. Sado të thuren lavde e të përmendet plot krenari mbretëresha ilire, e cila, sipas disa burimeve, diti të organizojë me gjasë një shtet me të drejta edhe për gratë.

Ajo mbetet vetëm një Teutë

Ngrihet lart Rozafa e legjendës së murimit, po Rozafa

nderohet për vetëmohimin!

Bukuria rrëqethëse e kësaj legjende nuk duhet të na bëjë të harrojmë, Rozafa u vra. Ajo nuk e kundërshtoi fatin e saj që ia përcaktuan burrat.

Po të kishte kundërshtuar Rozafa, të vendoste vetë për fatin e saj, do ekzistonte legjenda?

Edhe një Donikë, që i qëndroi në krah Gjergj Kastriotit e gjen, por edhe roli i saj ishte ai i gruas besnike, ajo ishte aty për të nxjerrë në pah forcën e mençurinë e luftëtarit legjendar.

Jo pak burra, në rast të kërcënimit të nderit e "burrërisë" (së keqkuptuar) e rivendosnin dhe e rivendosin atë duke përdorur dhunën fizike.

"Askush nuk është ndaj grave më agresiv dhe poshtërues, se një burrë që nuk është i sigurt në burrërinë e tij". Tradita, që burrërinë e vërtetë e shikon tek nderi arkaike e jo tek partneriteti, e ka bërë edhe burrin viktimitë, pre të modeleve patriarkale të edukuara që në fëmijëri. Jo se ai e urren femrën, ai ka thjesht frikë nga



prishja e ekuilibrit që i ka dhënë pushtetin prej shekujsh.

Një burrë gjen qëllimin e duhur në jetë dhe një grua gjen një burrë me qëllimin e duhur.

Shëmbëlltyrë për gruan dhe burrin ideal. Ishte një burrë që i shmangu lidhjet e martesës gjatë gjithë jetës së tij dhe kur po vdiste në moshën nëntëdhjetë vjeç, dikush e pyeti: Nuk jeni martuar kurrë, por kurrë nuk keni thënë pse?!

Nëse ka ndonjë sekret, zbulojeni edhe tani, në fund të fundit, ju jeni duke vdekur, duke e lënë këtë botë. Edhe nëse sekreti juaj dihet, nuk do t'ju dëmtojë. Plaku iu përgjigj: - Po, e mbaj një sekret. Nuk është se jam kundër martesës, por gjithmonë kam kërkuar gruan perfekte. E kalova gjithë kohën duke kërkuar dhe kështu jeta ime fluturoi. - Por me të vërtetë në të gjithë planetin e madh të banuar nga miliona njerëz, gjysma e të cilëve janë gra, nuk mund ta gjenit një dhe të vetmen grua ideale? Një lot i rrokullisi faqes së plakut që po vdiste. Ai u përgjigj: - Jo, gjeta një. - Atëherë çfarë ndodhi, pse nuk u martuat? Dhe plaku iu përgjigj: - Ajo grua po kërkonte mashkullin perfekt...

Epoka e platformave të trajnimit me shumë domene

Ndërsa operacionet ushtarake evoluojnë në zonën gri, operacionet kibernetike dhe me shumë domene, konceptet dhe sistemet e trajnimit gjithashtu duhet të avancojnë në mënyrë që të përgatisin operatorët për fushat e betejës së së ardhmes.

Mjegullimi i botëve fizike dhe dixhitale po krijon një ekosistem të ngjashëm me një metaverse ushtarake që do të ftojë një bashkëpunim më të ngushtë. Nick Brown, drejtor i marketingut dhe zhvillimit të biznesit Hadean – i Mbrojtjes, Lee Shearer, kreu i zhvillimit të biznesit PLEXSYS, MB, Evropë dhe Lindjen e Mesme, dhe David Head, kreu i partneriteteve strategjike të Thales, shqyrtojnë se si sistemet e trajnimit me shumë domene mund të ndikojnë në sektorin e mbrojtjes në të ardhmen.

Ushtritë moderne po përballen me kërcënime të pa-precedentë në një mjedis operativ në zhvillim që kërkon gatishmëri të vazhdueshme. Rritja e luftës hibride i ka shtyrë forcat e armatosura moderne të rivlerësojnë pragjet e njohura të konfliktit, ndërkohë që domenet në zhvillim, si hapësira dhe kibernetika, kanë krijuar domosdoshmërinë për të zhvilluar fije të avancuara të doktrinës ushtarake dhe kërkesave që i japin një kuptim të ri operacioneve të kombinuara të armëve.

Kohët e fundit, nevoja për të mbrojtur infrastrukturën kritike është theksuar gjithashtu, pasi miliona shtëpi, biznese dhe shërbime janë prekur nga sulmet në tubacionet e gazit nëndetëse dhe termocentralet e energjisë si rezultat i luftës në Evropën Lindore. Kjo ka rritur rëndësinë e gatishmërisë ushtarake dhe vendimmarrjes së shpejtë, të bazuar në të dhëna për skenarët e mundshëm dhe efektet e tyre të përhapjes përtej fushëbetesës.

E gjithë kjo është vendosur në një sfond të tendencave makro teknologjike që krijojnë mundësi të reja, si dhe pasiguri dhe kërcënim. Teknologjitë dixhitale e shtojnë dhe mbështesin gjithnjë e më shumë aktivitetin tonë në botën reale; mënyra se si qeveritë e menaxhojnë këtë turbullim të asaj fizike dhe virtuale nëpër rrjete gjithnjë e më komplekse do të jetë çelësi i suksesit ose dështimit.

Kjo zbatohet gjithashtu për përvojën e përdoruesit të ushtarëve, pilotëve dhe marinarëve që kanë nevojë për një mënyrë të qëndrueshme, intuitive dhe të aksesueshme për të aksesuar informacionin, për të mbështetur vendime të mira dhe të shpejta dhe për të parandaluar gabimet. Pasojat e shpërndarjes së gabuar të burimeve ose dështimit të navigimit, për shembull, mund të jenë të rënda në një mjedis operativ të drejtpërdrejtë. Pikërisht në këto rrethana ne kemi filluar të shohim të shfaqet nocioni i një "metaverse ushtarake".

Mjedise të izoluar trajnimi

Për 20 vitet e fundit, simulimet specifike të trajnimit në domen u kanë dhënë udhëheqësve të qeverisë dhe ushtarakëve aftësinë për t'u trajnuar për situata të botës



reale dhe për të zhvilluar aftësitë dhe taktikat më të përshtatshme për rezultatet pozitive që duhen arritur. Për shembull, pilotët luftarakë janë në gjendje të praktikojnë manovra në simulimet stërvitore që përdorin një kombinim të realitetit të shtuar, AI dhe motorëve interaktivë të lojës.

Megjithatë, ndërkohë që bota fizike vazhdon të bëhet gjithnjë e më komplekse, kufizimet teknike të infrastrukturës së llogaritjes së trashëguar kanë vendosur, deri më tani, një kufi të vështirë për atë që mund të arrihet me simulatorët e drejtpërdrejtë, virtualë dhe konstruktivë (LVC). Ndërsa përfitimet e simulimeve zhytëse dhe me ndikim për të ndihmuar në trajnimin e ushtarëve, marinarëve dhe pilotëve janë të mëdha, sistemet aktuale ndërtohen dhe përdoren të izoluar nga njëri-tjetri, duke kufizuar potencialin e tyre për rritjen e shkallës, lidhjes dhe ndërveprimit.

Pa sinkronizim në kohë reale, trajnimi sintetik nuk është në gjendje të pasqyrojë ndërlikimet e mjedisit të sotëm kompleks operativ ku veprimi në të gjithë domenet ushtarake zhvillohet njëkohësisht.

Pa fuqinë llogaritëse të nevojshme për të shkurtuar një fluks të dhënash dhe informacioni, trajnerët sintetikë të fragmentuar janë gjithashtu të kufizuar në aftësinë e tyre për të ushqyer në mënyrë dinamike të dhëna për analitikë dhe mbështetje vendimesh. Si rezultat, ushtrime në terren në shkallë të gjerë, të shtrenjta dhe komplekse logjistike përdoren për të kompensuar mungesën e trajnimit sintetik të vetëm me shumë fusha.

Konvergenca e virtuale dhe asaj fizike

Nuk është më e pranueshme që këto ushtrime të zhvillohen të izoluar. Bota po ndryshon dhe shprehja e vjetër "përshtat ose vdis" lind në mendje; vazhdimi i një qasjeje të heshtur vetëm do të krijojë pengesa për bashkëpunimin dhe

do të kufizojë aftësinë e ushtrisë për të kryer në mënyrë efektive ushtrime dhe trajnime të përbashkëta; trajnim që vërtet mbështet integrimin me shumë domene.

Kthimi drejt kornizave teknike më të decentralizuara do të na lejojë të sjellim idetë, të dhënat dhe simulimet nën një çati. Ideja e një metaverse ushtarake është abstrakte, por shërben si një përshkruar që përmbledh ekosistemin e teknologjive që na lejojnë të bashkojmë fusha dhe aktivitete të ndryshme në një hapësirë të vetme virtuale. Mjediset e vetme sintetike janë ndër rastet e para të kësaj teknologjie që përfshihet në gjuhën ushtarake. Këto simulime të federuara të trajnimit lejojnë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë nëpër fusha dhe madje edhe organizata heterogjene si NATO.

Një ndryshim në doktrinën e trajnimit ushtarak

Rrjedhimisht, udhëheqësit ushtarakë dhe qeveritarë kanë kërkuar të formojnë kohezion të gjerë ushtarak rreth një shtylle thelbësore të teknologjive dixhitale që mund të ndihmojnë për të arritur gatishmërinë dhe optimizimin në operacione, nga trajnimi dhe lojërat luftarake deri te analiza e të dhënave të drejtpërdrejta dhe mbështetja e vendimeve. Vizioni për përdorimin e mjediseve sintetike në ushtritë moderne është përshkallëzuar nga simulimet specifike të fushës dhe skenarit në një përzjerje të trajnimit LVC që do të lejojë aktorët nga fusha të ndryshme të trajnohen dhe të bashkëpunojnë së bashku në të gjitha klasifikimet në një mjedis të vetëm sintetik gjithëpërfshirës dhe me besnikëri të lartë.

Nuk duhet kërkuar larg për të kuptuar se forcat e armatosura janë të vetëdijshme për nevojën për këtë rrugë bashkëpunuese. Duke demonstruar një qasje për të ardhmen, po zhvillohen programe ambicioze për të shfrytëzuar mundësitë e mjediseve të përziera fizike/virtuale të shkallëzueshme dhe të integruara dhe për të ofruar trajnime realiste dhe të përsëritshme.

Është e qartë se teknologjitë dhe aplikacionet e platformës që mbështesin lojërat në internet dhe metaverset janë të njëjta që do të sjellin nivelin tjetër të epërsisë ushtarake.

Në Mbretërinë e Bashkuar, programe si Kapaciteti i

Trajnimit Operacional i Mbrojtjes (Detare) dhe Trajneri i Komandës dhe Stafit Detar janë fokusuar në mundësinë e ndërveprimit të simulimeve për të lidhur anijet dhe sistemin e bazuar në breg dhe për të modernizuar ofrimin e trajnimit të Marinës Mbretërore. Programi i Gladiatorit të Forcave Ajrore Mbretërore është një tjetër përpjekje që kërkon të përmirësojë besnikërinë dhe kompleksitetin e trajnimit të pilotëve nga simulatorët e rrjetit të vendosur në vende të ndryshme për të shumëfishuar efektin e stërvitjes dhe për të përshpejtuar përgatitjen e forcës.

Në fushën e tokës, Programi i Transformimit të Trajnimit Kolektiv po transformon mënyrën se si ushtarët stërviten së bashku, duke federuar sisteme për të përfshirë luftën me shumë domene, duke bërë jehonë të skenarëve të botës reale me besueshmëri të lartë dhe për të mundësuar shfrytëzimin e kapjes së të dhënave në përputhje me fokusin më të gjerë të Mbrojtjes në trajnime të bazuara në të dhëna dhe vendimmarrje.

Rruga përpara


Arritja e integritetit ndërmjet sistemeve paraqet një sfidë të menaxhimit dhe shpërndarjes së të dhënave me sisteme të ndryshme që kërkojnë konsolidim kompleks. Një sasi e madhe e fuqisë llogaritëse është thelbësore, së pari: për të menaxhuar numrin dhe madhësinë masive të subjekteve ndërvepruese dhe së dyti: për të lundruar në rrjetin e ndërlikuar që vjen me konvergimin e pikave të shumta të të dhënave nga vende të ndryshme. Ndërsa janë ende në një fazë eksperimentale, të gjitha këto ndërhyrje stërvitore me performancë të lartë dhe të tjerat që do të vijnë, të cilat do të përdoren për të formuar një metaverse ushtarake plotësisht të mishëruar, do të furnizohen vetëm nëpërmjet fuqisë së kombinuar të informatikës cloud të shpërndarë, simulimeve me shumë domene me cilësi të lartë dhe teknologjisë AI.

Koncepti i një metaverse ushtarake të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe me performancë të lartë do të nxisë bashkëpunimin. Kompleksiteti i sfidave teknike, kërkesa për të ofruar zgjidhje që do t'i mbrojnë shërbimet e armatosura në të ardhmen dhe do të sigurojnë ruajtjen e avantazhit konkurrues përpara kundërshtarëve do të kërkojnë një qasje të përbashkët. Do të duhet të ketë një konglomerat midis kompanive komerciale, akademisë dhe ushtrive që punojnë së bashku brenda ekosistemeve të teknologjive të ndërveprueshme.

Ku po shkon e ardhmja e trajnimit të mbrojtjes?

Metaversi, të cilin ne e përcaktojmë këtu si një hapësirë në të cilën bota fizike dhe dixhitale ndërveprojnë për të rritur kuptimin dhe përvojën tonë të botës reale, në të ardhmen e afërt do të ketë një ndikim shumë real në jetën civile dhe mënyrat se si ne komunikojmë, mësojmë, socializojmë dhe strukturojmë ekonominë tonë. Ushtria do të duhet të ndryshojë mendimin e saj për t'u lidhur me përparimet që po sjell "Web 3.0".

Është e qartë se teknologjitë dhe aplikacionet e platformës që mbështesin lojërat në internet dhe metaverset janë të njëjtat që do të çojnë në nivelin tjetër të epërsisë ushtarake, duke nxitur inovacionin me një ritëm që do të plotësojë nevojat e kushteve globale që ndryshojnë me shpejtësi. Ekziston një lidhje midis botëve të mbrojtjes dhe metaverses, sepse brezat e ardhshëm do të jenë tashmë të njohur me këto platforma dhe trupat e së nesërme do të presin të stërviten në mjedise sintetike të vetme me shumë shtresa dhe shumë-disiplinore.



Mjedisi i Trajnimit të Vazhdueshëm të Marinës së SHBA mundëson trajnime konstruktive virtuale live me sisteme të drejtpërdrejta dhe sintetike në të gjithë globin. Foto: Ron Keter

Tregu i vetëm evropian mbush 30 vjeç

Mbi 30 vjet, Tregu Unik ka çuar në një integrim të paprecedentë tregu midis ekonomive të Shteteve Anëtare, duke shërbyer si një shtytës për rritje dhe konkurrencë dhe duke mbështetur fuqinë ekonomike dhe politike të Evropës në nivel global.

Këtë vit, BE-ja feston 30-vjetorin e Tregut të saj Unik – një nga arritjet kryesore të integritetit evropian dhe një nga shtytësit kryesorë të tij. I themeluar më 1 janar 1993, Tregu Unik Evropian lejon që mallrat, shërbimet, njerëzit dhe kapitali të lëvizin lirshëm nëpër BE, duke e bërë jetën më të lehtë për njerëzit dhe duke hapur mundësi të reja për bizneset.

Mbi 30 vjet, Tregu Unik ka çuar në një integrim të paprecedentë tregu midis ekonomive të Shteteve Anëtare, duke shërbyer si një shtytës për rritje dhe konkurrencë dhe duke mbështetur fuqinë ekonomike dhe politike të Evropës në nivel global. Ai gjithashtu luajti një rol kyç në përshpejtimin e zhvillimit ekonomik të shteteve të reja anëtare që iu bashkuan BE-së, duke hequr barrierat për hyrjen dhe duke nxitur rritjen.

Kohët e fundit, Tregu i Vetëm ka qenë thelbësor për të ndihmuar Evropën që të përballet me pandeminë COVID-19 dhe

krizën energjetike që rezulton nga pushimi rus i Ukrainës. Ruajtja dhe forcimi i integritetit të Tregut të Vetëm do të mbetet thelbësor për t'i lejuar Evropës t'i përgjigjet sfidave të reja në mënyrë të koordinuar dhe të vazhdojë të mbështesë konkurrencën e ekonomive evropiane.

Falë Tregut të Vetëm, BE-ja ka qenë në gjendje të përmirësojë jetën e të gjithë evropianëve duke përfshirë:

Përshpejtimi i tranzicionit drejt një ekonomie më të gjelbër dhe dixhitale: Marrëveshja e Gjelbër Evropiane është strategjia e rritjes e BE-së. Bazuar në propozimet e BE-së "Fit For 55" dhe Dekadës Dixhitale, BE-ja po vendos një kuadër rregullator për të mbështetur tranzicionin e gjelbër dhe dixhital të Evropës. Strategjia Industriale po shoqëron industrinë e BE-së në këto tranzicione. Tregu i vetëm ndihmon gjithashtu në sigurimin e disponueshmërisë së vazhdueshme të inputeve thelbësore për bizneset tona, duke përfshirë lëndët e para kritike dhe teknologjitë e avancuara si gjysmëpërçuesit.

Garantimi i sigurisë së lartë dhe standardeve kryesore teknologjike globale: Legjislacioni i BE-së i lejon konsumatorët të besojnë se të gjitha produktet në Tregun e Vetëm janë të sigurta dhe të bazuara në standarde të larta të mbrojtjes së mjedisit, punës, të dhënave personale dhe të të drejtave të njeriut. Këto rregulla dhe standarde përdoren shpesh në mbarë botën, duke u dhënë bizneseve evropiane një avantazh konkurrues dhe duke rritur pozitën globale të Evropës, ndërkohë që inkurajojnë një garë drejt majave për sa i përket standardeve. Sot, BE-ja është një përcaktuese globale e standardeve.

Përgjigjja ndaj krizave të fundit me shpejtësi dhe vendosmëri të paprecedentë: Adresimi i krizave të fundit si pandemia COVID-19 dhe kriza aktuale e energjisë mbështetet në një qasje të përbashkët dhe të koordinuar evropiane. Gjatë COVID-19, mbajtja e kufijve të brendshëm të hapur dhe siguri i funk-



sionimit të qetë të Tregut të Vetëm lejoi që vaksinat, pajisjet mjekësore dhe materialet e tjera kritike të arrinin tek ata në nevojë. Sot, përgjigja e Evropës ndaj krizës energjetike bazohet në planin REPowerEU, i cili mbështetet në fuqinë e Tregut të Vetëm për BE-në për të blerë bashkërisht burime më të larmishme të energjisë dhe për të përshpejtuar ndjeshëm zhvillimin dhe vendosjen e energjisë së pastër dhe të rinovueshme. Kjo tashmë ka rezultuar në reduktimin e varësisë së BE-së nga karburantet fosile ruse.

Për të siguruar që tregu i vetëm të mbetet një e mirë e përbashkët që ofron për të gjithë njerëzit në BE, Komisioni punon vazhdimisht në zhvillimin e tij në fusha të reja dhe siguron që rregullat që janë tashmë në fuqi të funksionojnë në praktikë. Për këtë qëllim, Komisioni punon ngushtë me autoritetet publike të Shteteve Anëtare, të cilat ndajnë përgjegjësinë për zbatimin efektiv të rregullave të tregut të vetëm.

Në dhjetor 2022, gjatë fillimit të serisë së ngjarjeve për të shënuar 30 vjetorin e Tregut Unik, Komisioni prezantoi një dokument analitik mbi gjendjen e Tregut të Vetëm 30 vjet pas krijimit të tij dhe rolin e tij si nxitës i qëndrueshmërisë së BE-së. Gjatë vitit 2023, do të ketë debate, ekspozita dhe fushata të shumta të bashkëorganizuara me palët e interesuara në të gjithë BE-në për të promovuar sukseset e Tregut Unik dhe për të angazhuar qytetarët në diskutimin e së ardhmes së tij. Në këtë kontekst, Komisioni do të nxjerrë një komunikatë ku do të prezantohen arritjet dhe përfitimet e rëndësishme të Tregut të Vetëm, duke identifikuar gjithashtu boshllëqet e zbatimit dhe prioritetet e ardhshme që Tregu i Vetëm të vazhdojë të luajë një rol kyq.

Tregu unik u krijua më 1 janar 1993. Ai pasoi nënshkrimin e Traktatit të Mastroitit më 7 shkurt 1992. Fillimisht, 12 vende të BE-së përbënin Tregun e vetëm: Belgjika, Danimarka, Gjermania, Irlanda, Greqia, Spanja, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia dhe Mbretëria e Bashkuar. Sot, Tregu Unik përbëhet nga 27 Shtete Anëtare, si dhe Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, me Zvicrën që ka akses të pjesshëm.

Trafikimi i qenieve njerëzore: Rregulla më të forta për të luftuar krimin në zhvillim

Komisioni propozoi forcimin e rregullave që parandalojnë dhe luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore. Çdo vit mbi 7000 njerëz bëhen viktima të trafikimit të qenieve njerëzore në BE. Kjo shifër mund të pritet të jetë shumë më e lartë pasi shumë viktima mbeten të pazbuluara. Kostoja vjetore e trafikimit të qenieve njerëzore në BE arrin në 2.7 miliardë euro. Shumica e viktimave janë gra dhe vajza, por përqindja e viktimave meshkuj është gjithashtu në rritje, veçanërisht për shfrytëzimin e punës. Format e shfrytëzimit kanë evoluuar vitet e fundit, me krimin duke marrë gjithnjë e më shumë një dimension online. Kjo kërkon veprime të reja në nivel të BE-së, pasi trafikantët përfitojnë nga mundësitë për të rekrutuar, kontrolluar, transportuar dhe shfrytëzuar viktimat, si dhe për të lëvizur fitimet dhe për të arritur tek përdoruesit në BE dhe më gjerë. Rregullat e përditësuara do të ofrojnë mjete më të forta për autoritetet ligjzbatuese dhe gjyqësore për të hetuar dhe ndjekur penalisht format e reja të shfrytëzimit. Për shembull, duke u siguruar që përdorimi me vetëdije i shërbimeve të ofruara nga viktimat e trafikimit përbën një vepër penale. Propozimi i Komisionit parashtrohet sanksione të detyrueshme ndaj kompanive për vepra penale të trafikimit dhe jo vetëm ndaj individëve. Ai synon gjithashtu të përmirësojë procedurat për identifikimin dhe mbështetjen e hershme të viktimave në Shtetet Anëtare, veçanërisht përmes krijimit të një Mekanizmi Evropian të Referimit.

Kroacia i bashkohet zonave Euro dhe Shengenit

Nga data 1 janar 2023, Kroacia fut në përdorim euron si monedhë të saj dhe do t'i bashkohet plotësisht zonës Shengen. Kjo shënon një moment historik të rëndësishëm në historinë e Kroacisë, të zonës së euros dhe Shengenit dhe të BE-së në tërësi, që pason një periudhë përgatitjesh intensive dhe përpjekjesh thelbësore nga Kroacia për të përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme.

Komisioni ka mbështetur plotësisht Kroacinë në procesin e anëtarësimit në euro dhe zona Shengen. Me Kroacinë, 20 shtete anëtare të BE-së dhe 347 milionë qytetarë të BE-së do të ndajnë monedhën e përbashkët të BE-së. Për sa i përket Shengenit, ky është zgjerimi i tetë dhe i pari pas 11 vitesh. Euro do të sjellë përfitime praktike për qytetarët dhe bizneset kroate. Do ta bëjë më të lehtë udhëtimin dhe jetesën jashtë vendit, do të rrisë transparencën dhe konkurrencën e tregjeve dhe do të lehtësojë tregtinë. Kartëmonedhat dhe monedhat euro do të bëhen gjithashtu një simbol i prekshëm për të gjithë kroatët. Mbështetja publike për euron në zonën e euros mbetet shumë e fortë, me shumicën e gjerë të qytetarëve të BE-së që besojnë se euro është një gjë e mirë për BE-në në tërësi dhe për vendin e tyre. Zona Shengen lejon 420 milionë njerëz të udhëtojnë lirshëm midis vendeve anëtare pa kaluar nëpër kontrole kufitare. Ai lejon zhvillimin e një përgjegjësie të përbashkët, të përbashkët për kontrollin e kufijve të jashtëm të Bashkimit dhe përgjegjësinë për lëshimin e vizave të përbashkëta Shengen. Mbi shifrat, prej më shumë se 35 vitesh Shengeni është një zonë vlerash, lirie, sigurie dhe drejtësie. Veçanërisht në kontekstin aktual gjeopolitik dhe ekonomik, zona Shengen është thelbësore për stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe rimëkëmbjen.

“Armët janë rruga drejt paqes”

Jens Stoltenberg: Nuk ka paqe të qëndrueshme nëse tirania mbizotëron mbi lirinë

Fjalimi i mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në Konferencën Vjetore të Konfederatës Norvegjeze të Ndërmarrjeve në Oslo, më 5 janar 2023

“Nuk do të ketë paqe të qëndrueshme nëse shtypja dhe tirania fitojnë mbi lirinë dhe demokracinë”, - deklaroi Stoltenberg. Ai theksoi nevojën që aleatët të investojnë më shumë në mbrojtje, eliminonjë varësitë nga regjimet autoritare dhe të qëndrojnë së bashku për të mbështetur lirinë dhe demokracinë.

Në një botë krejtësisht të ndryshme. Nuk ka më shembje të mureve të ndryshkur. Por ndërtimi i gardheve të reja, të përmirësuara. Zbutja është kthyer në tension të lartë dhe luftë të re. Regjimet autoritare po ngrihen. Demokracia po tërhiqet. Globalizimi është në rënje.

Sot, ky realitet i ri është më i dukshëm përmes luftës së agresionit të Presidentit Putin kundër Ukrainës. Brutaliteti ka tronditur shumë. Por nuk ka asnjë arsye për t'u habitur. Ne e pamë këtë luftë që po vinte.

Është pjesë e një modeli ku Moskë përdor forcën ushtarake për të arritur qëllimet e saj politike.

Brutaliteti në Grozny, pushtimi i Gjeorgjisë, bombardimi i Aleppos dhe lufta në Ukrainë nuk filloi shkurtin e kaluar. Filloi në vitin 2014, me aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe sulmet në Ukrainën Lindore.

Por nuk është vetëm ky model që nuk na befaso. Në NATO, ne kishim gjithashtu inteligjencë të saktë për grumbullimin e forcave ruse përgjatë kufirit dhe planet e tyre

konkrete. Ne e bëmë publik këtë informacion dhe paralajmëruam për një pushtim të mundshëm prej muajsh.

Ne kemi bërë vazhdimisht përpjekje të rëndësishme politike dhe diplomatike për të parandaluar luftën. Por presidenti Putin ende zgjodhi të sulmojë.

NATO ishte përgatitur. Që nga viti 2014, ne kemi kryer ristrukturimin më të madh të aleancës që nga fundi i Luftës së Ftohtë, duke vendosur më shumë trupa të NATO-s në vendet tona anëtare.

Rritja e gatishmërisë së forcave tona. Krijimi i fushave të reja të mbrojtjes, të tilla si kibernetike.

Dhe jo më pak e rëndësishme, aleatët e NATO-s kanë investuar më shumë në mbrojtje. Përveç kësaj, Finlanda dhe Suedia janë në rrugën e tyre për t'u bashkuar me NATO-n. Disa orë pas pushtimit, ne aktivizuam planet tona të mbrojtjes dhe rritëm ndjeshëm praninë tonë ushtarake, nga Deti Baltik në Detin e Zi. Tani kemi edhe më shumë ushtarë në gatishmëri të lartë.

Kjo nuk është për të provokuar një konflikt, por për të parandaluar që lufta në Ukrainë të shndërrohet në një luftë të plotë midis NATO-s dhe Rusisë. Dhe për të hequr çdo vend për keqkuptime dhe gjykime të gabuara në Moskë në lidhje me aftësinë dhe vullnetin tonë për të mbrojtur territorin e NATO-s.

Mbrojtja e fortë siguron paqen. Vendet e NATO-s dhe NATO gjithashtu

tu japin kontribut të rëndësishëm në Ukrainë. Norvegjia është një nga vendet që kontribuon. Mbështetja ushtarake që ofron Norvegjia bën diferencën dhe vihet re. Nëse Putini fiton në Ukrainë, do të jetë një tragjedi për ukrainasit. Por është edhe e rrezikshme për ne. Mesazhi për të dhe për liderët e tjerë autoritarë do të jetë se nëse përdorin forcën ushtarake, do të marrin atë që duan. Do të na bëjë më të pambrojtur. Nuk do të ketë paqe të qëndrueshme nëse shtypja dhe tirania fitojnë mbi lirinë dhe demokracinë.

Luftërat janë të paparashikueshme. Është e pamundur të thuhet se kur, apo si do të përfundojë lufta në Ukrainë. Por ajo që dimë është se shumica e luftërave përfundojnë në tryezën e bisedimeve. Me shumë mundësi edhe kjo. Çfarë mund të arrijnë ukrainasit në tryezë varet nga forca e tyre në fushën e betejës.

Pra, nëse duam një zgjidhje paqeje të negociuar, ku Ukraina të mbijetojë si një vend i pavarur demokratik në Evropë, mënyra më e shpejtë për të arritur atje është të mbështesësh Ukrainën.

Armët janë – në fakt – rruga drejt paqes. Pavarësisht se kur dhe si përfundon

kjo luftë, ne duhet të pranojmë se situata e sigurisë në Evropë ka ndryshuar përgjithmonë.

Regjimi në Moskë do një Evropë tjetër. Ajo dëshiron të kontrollojë vendet fqinje dhe e sheh demokracinë



dhe lirinë si një kërcënim. Kjo e vendos Rusinë në një pozicion konflikti të vazhdueshëm me Perëndimin. Pra, edhe nëse kjo luftë përfundon, problemet në marrëdhëniet tona me Rusinë vazhdojnë.

Forcat ukrainase i kanë shkak-tuar humbje të rënda Rosisë në Ukrainë. Por rusët kanë treguar edhe një herë gatishmërinë për të marrë rreze të mëdha dhe për të duruar humbje të mëdha njerëzore. Ata tashmë kanë mobilizuar 200 000 trupa shtesë.

Përveç kësaj, ne e dimë se ata mund të marrin shumë materiale të reja. Dhe ndoshta më e rëndësishmja, nuk ka asnjë tregues se ambiciet e Rosisë kanë ndryshuar. Është e rrezikshme të nënvlerësoh Rusinë.

Më lejoni të ndaj tre mësimë që besoj se mund të mësojmë tashmë nga lufta në Ukrainë.

Së pari, ne duhet të investojmë edhe më shumë në mbrojtje. Ky ka qenë mesazhi i NATO-s për një kohë të gjatë. Dhe më keni dëgjuar të flas për këtë shumë herë më parë. Tani mendoj gjithashtu se të gjithë e shohin se ne kemi nevojë për një mbrojtje më të fortë, me trupa në gatishmëri më të lartë. Pajisje moderne. Dhe ushtarë të trajnuar mirë. Kushton para.

Mësimi i dytë është se është e rrezikshme të varesh nga regjimet autoritare. Jo shumë kohë më parë shumë besonin se blerja e gazit nga Rusia ishte thjesht një çështje tregtare. Realiteti është se është një çështje politike. Bëhet fjalë për sigurinë tonë. Biznesi është edhe politikë. Ne nuk duhet ta përsërisim

këtë gabim me regjimet e tjera autoritare. Jo më pak Kina.

Ne nuk duhet ta bëjmë veten të pambrojtur duke u bërë shumë të varur nga lëndët e para dhe produktet kritike. Ne nuk duhet të eksportojmë teknologji që, nga ana tjetër, mund të përdoret për të na kërcënuar. Ne nuk duhet të humbasim kontrollin e infrastrukturës kritike, e cila është thelbësore si për shoqërinë civile ashtu edhe për veprimtarinë ushtarake. Si portet, hekurudhat, telekomunikacioni – rrjetet 5G. Ne do të vazhdojmë të tregtojmë me Kinën. Por kjo duhet bërë në mënyra që nuk cenojnë sigurinë tonë. Është një përgjegjësi e përbashkët.

Autoritetet kanë përgjegjësinë për të vendosur rregulla dhe korniza. Por kompanitë kanë gjithashtu një përgjegjësi të pavarur për të ushtruar kujdesin e duhur. Nuk mund të marrim si pikënisje që çdo projekt fitimprurës duhet të realizohet, vetëm sepse është fitimprurës. Interesat ekonomike afatshkurtra nuk mund të tejkalojnë interesat themelore kombëtare.

Thuhet shpesh se lufta është shumë serioze për t'u lënë në dorë gjeneralëve. Në mënyrë të ngjashme, mund të themi se aktivitetet e biznesit janë shumë serioze për t'u lënë vetëm drejtuesve të biznesit.

Mësimi i tretë është se regjimet autoritare kanë rritur bashkëpunimin e tyre. Disa javë para pushtimit rus të Ukrainës, presidenti Putin dhe presidenti Xi u takuan në Pekin. Ata shpallën një partneritet strategjik "pa kufij". Rusia dhe Kina

stërviten dhe veprojnë më shumë së bashku ushtarakisht. Ata kanë një bashkëpunim ekonomik në rritje. Kina nuk e ka dënuar pushtimin rus të Ukrainës. Përkundrazi, ata promovojnë narrativën ruse, e cila ia hedh fajin NATO-s.

Kina ka mbështetur për herë të parë kërkesën e Rosisë që NATO të mbyllë derën e saj për shtetet e reja anëtare. Jo vetëm që po forcohet bashkëpunimi midis Rosisë dhe Kinës, por Rusia po ndërton edhe lidhje më të ngushta me regjime të tjera autoritare, si Irani dhe Koreja e Veriut.

Këto janë regjime të ndryshme. Por ata kanë të përbashkët se promovojnë një rend botëror alternativ. Ata mbrojnë vlerat që cenojnë besimin tonë në liri dhe demokraci. Në një botë më të rrezikshme, është edhe më e rëndësishme që ne, që besojmë në liri dhe demokraci, të qëndrojmë së bashku.

Jo sepse kemi gjithmonë të drejtë.

Jo sepse nuk gabojmë kurrë.

As sepse jemi gjithmonë dakord.

Por sepse ndajmë të njëjtat vlera.

Dhe sepse ne jemi shumë më të fortë së bashku sesa vetëm.

NATO përfaqëson 50 për qind të fuqisë ekonomike botërore dhe 50 për qind të fuqisë ushtarake botërore. Në një farë mënyre, kjo është gjysma e botës së bashku për të siguruar paqen për njëritjetrin. Dhe të vazhdojmë të ruajmë lirinë dhe demokracinë tonë.

Pra, për sa kohë që ne kujdesemi për NATO-n, NATO do të kujdeset për të gjithë ne.

Xhubleta Shqiptare, veshja unike, tashmë pasuri e gjithë njerëzimit

Veshje tipike e grave në Shqipërinë Veriore, mbi lumin Drin, Nikaj-Mërtur e Rugovë, Malësi e Madhe dhe e shqiptarëve të Malit të Zi, në zonën e Nën Shkodrës deri në Breg të Matit, ku malësorët e Malësisë së Madhe kanë zbritur.

Xhubleta është një fund në trajtë kambane, që vjen i valëzuar për fundi, sidomos në pjesën e mbrapme. Përbëhej nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, qepur horizontalisht dhe të ndërthurur me breza gajtanësh. Mbahet e varur në supe me dy rripa të gjerë.

Xhubleta shqiptare, e lashtë 4 mijë vjet, është pranuar në listën Trashëgimisë Kulturore jo-materiale, nën mbrojtjen e UNESCO-s

Xhubleta është një veshje e punuar me dorë, që vishej nga gratë dhe vajzat malësore në Shqipërinë e Veriut, por edhe në një pjesë të Malit të Zi dhe Kosovës.

Është kryesisht e zezë, e punuar në masë të madhe me pëlhurë leshi dhe me motive të qëndisura shumëngjyrëshe. Karakteristikë e saj është pjesa e poshtme në formë të kambanës.

Filja, sot 70 vjeçe, kujton ende në detaje gjithçka nga procesi i bërjes së një xhublete.

“E zgjidhnim leshin e deles ku ishte më i miri, e shprishnim, e lërnim dhe e turrnim. Mjetet që duheshin për ta përgatitur xhubletën, ishin: koshi i spikut, veku dhe vajanica. Tirkur bëhej në vek (tezgjah) dhe kur përfundonte, e çonim në vajanicë, që ka qenë një vegël prej druri... Ishin si dy çekiçë prej druri që komandohehin nga forca e ujit, godisnin tirkun dhe krejt copa ngjeshej”, - kujton Filja për “Radio Evropa e Lirë”.

Javën e kaluar, Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) e mori nën mbrojtje xhubletën.

Kjo veshje, e vjetër 4 mijë vjet, dikur përdorej në jetën e përditshme.

Megjithatë, përdorimi dhe prodhimi i saj ka qenë në rënie gjatë dekadave të fundit, si për arsye socio-politike, ashtu edhe për arsye ekonomike.

Filja kujton se në kohën e rinisë së saj nuk kishte bojëra për të ngjyrosur leshin e deles, por se ato bëheshin duke zier lëvozhga verri, gjethe frashri, si



dhe një gur me ngjyrë blu që thotë se quhej karaboj.

Tetë xhubleta në pajë

“Unë jam martuar me xhubletë dhe kam pasur tetë xhubleta në pajë. Më e mira ishte ajo që veshja kur u bëra nuse dhe e përdorja kur kishim festa. Xhubleta pas së mirës ishte ajo që e vishja kur të afërmit na ftonin në dreka dhe darka, ndërsa të tjerat i kisha për t'i mbajtur përditë”, - thotë Filja.

Me keqardhje, ajo tregon se sot i ruan vetëm dy prej tyre.

"Ishin kohë të vështira, varfëri... Të besohet që gjashtë xhubleta i kam prishur dhe me to kam bërë qilima, apo shtrojë, apo mbulojë? Më vjen të qaj kur e kujtoj. Më janë dhimbsur shumë kur i kam prishur se i kisha bërë me këto duar, por nuk kam pasur rrugë tjetër", - thotë Filja.

Ajo nuk jeton më në fshatin e saj të lindjes, Vermosh, ku edhe mësoi zanatin, por në Shkodër.

Për ta ruajtur këtë traditë, por edhe për të siguruar të ardhura për veten dhe bashkëshortin, Filja, në shtëpinë e saj, vazhdon të qepë xhubleta dhe tirq, veshje që dikur përdornin burrat malësorë.

Ajo thotë se numrin më të madh të porosive e ka nga emigrantët në Shtetet e Bashkuara.

"Ata i duan xhubletat dhe tirqit ashtu siç kanë qenë dikur, origjinale. Është një punë që merr shumë kohë.

Më duhet t'i blej stolitë, t'i mbledh nëpër zona të ndryshme, dikush shet një varësë, dikush hajmalinë, dikush postavën, apo brezin e hekurit që kanë mbajtur gratë dikur...", - rrëfen Filja.

Ajo thotë se më së shumti punon imitime të xhubletës, pasi kështu mund t'ia dalë për të siguruar më lehtë të ardhura. Për ta qepur atë në formën origjinale, thotë se i duhet mbështetje edhe nga institucionet.

Xhubleta për raste të ndryshme

Për të punuar një xhubletë dasme apo festash, duhen gjashtë deri në nëntë muaj kohë.

Xhubletat e përditshme, kërkojnë më pak kohë, sepse nuk kanë punime të veçanta dhe qëndisje.

Xhubleta e 'vdekjes' (që ruhej dhe vishej kur varrosej një grua) gjithashtu ka kërkuar kohë, sepse ka pasur shumë punime në pjesën e përparme të saj.

Rikthehet tradita e daljes së nuses me xhubletë

Në zonën e Kelmendit, pjesa veriore e Shqipërisë,

shumë familje i ruajnë xhubletat e hershme.

"Është e vështirë ta mbash dhe ta veshësh. Xhubleta duhet palosur me kujdes që konet e saj të rrinë në pozicionin e duhur. Jo kushdo di ta ruajë dhe ta veshë", - thonë punueset e xhubletës.

"Ta shohësh një nuse nga afër me xhubletë, ishte shumë bukur", - shprehen ato.

Një prej stolive që ruajnë, është edhe varësja e mashave.

"Xhubleta ka pasur shumë qëndisje dhe shumë stoli. Peshonte rreth 14-15 kilogramë si veshje. Një prej stolive ishte edhe varësja e mashave, që gruaja malësore e mbante varur në qafë. Në fund të varësës është një si gërsërë e vogël. Me të, gruaja merrte një gacë nga oxhaku dhe ndizte çibukët e burrave në odë".

Ato thonë se një tjetër pjesë e stolive ka qenë edhe hajmalia, ku nuses i hidheshin napolona ari gjatë kërcimit.

Xhubleta nuk është thjesht një veshje, ajo është rit, kulturë shekullore, traditë

Të vishje një xhubletë nuk ishte thjeshtë një rutinë e përditshme.

Në shek. XVIII, xhubleta përbëhej nga shumë ngjyra, por ato që na kanë mbërritur në ditët e sotme janë: të zeza për gratë dhe bardhë e zi për vajzat. Pjesë të tjera të kostumit me xhubletë janë: kraholinë, xhoka, kërdhokla, paraniku, kallmat e shputat, etj.

Xhubleta është me prejardhje të lashtë. Paraqet ngjashmëri me veshjen e disa figurinave neolitike të gjetura në Bosnje, por edhe në vise të tjera të Mesdheut, që i përkasin mijëvjeçarit të dytë para erës sonë dhe lidhen me qytetërimet e vjetra mesdhetare.

Xhubleta e Malësisë është trashëgimi e qartë e prejardhjes ilire të kulturës tonë, që malësorët e përcollën deri në vitet 1950-1960, pra përbën një nga elementët identifikues të veshjes popullore shqiptare, nëpërmjet motiveve, ku emblema për të gjitha është shqiponja.



(Në kuadrin e 20-vjetorit të ndarjes nga jeta)

GJENERAL THOMA XHIXHO, i pari komandant i Akademisë Ushtarake Shqiptare



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

U formua në ambientin patriotik shqiptar

Thoma Koço Xhixho ishte komandant i arsimit ushtarak shqiptar, drejtues i përgatitjes luftarake dhe njeri i mirë. Nisur nga ky mendim, shpresoj që tërë jetën e tij të paraqitur në këtë monografi, ta shtjelloj duke përdorur fakte të thjeshta dhe mendimin teorik e praktik. Me jetën dhe veprën e gjeneral Thoma Xhixhos jam njohur në vitin 2008, kur përgatitëm librin “50 vjet Akademi e Mbrojtjes” dhe në vitin 2018, kur në gazetën “Ushtria” botova shkrimin “Thoma Xhixho, personalitet i shquar i arsimit dhe i shkencës ushtarake”, në kuadrin e 60-vjetorit të krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA).

Shkrimi për personalitete të larta të vendit është nder, por dhe përgjegjësi, siç është edhe figura e gjeneralit Thoma Xhixho, i cili ishte patriot dhe ushtarak i lartë, ai ka luftuar, punuar dhe kontribuar në kohë historike për ngritjen dhe lartësimin e ushtrisë shqiptare. Ka qenë koha dhe momenti historik, që prunë në skenë lëvizjen dhe Luftën legjendare Antifashiste, e cila afirmoi dhe nxori në dukje mjaft patriotë e luftëtarë, midis të cilëve edhe Thoma Xhixhon, komandant e komisar i njëjseve sulmuese partizane. Sigurisht, Thomai ishte formuar me ndjenja patriotike që në rininë e tij, në ambientin patriotik shqiptar, në Suhë, fshati i lindjes, në gjirin e familjes patriotike Xhixho. Ai u edukua me frymën atdhetare, që

e përcollën në shekuj burrat dhe luftëtarët e hershëm të fshatit, të krahinës dhe të Gjirokastrës.

Nga studimi i historisë së karrierës dhe të kontributit atdhetar të gjeneral Thomait, të këtij antifashisti dhe luftëtari, ndien krenari për këtë figurë ushtarake dhe patriot që gjithë jetën qëndroi ushtar i atdheut. Ai vjen nga fisi i njohur Xhixho në Suhë të Gjirokastrës, një fshat i vogël i Shqipërisë së Jugut, në krahinën e Lunxhërisë, e njohur për me histori e tradita luftarake, me kapëdanë e luftëtarë të shquar, burra të mençur e të zotë dhe gra luftëtare të gjendura në krah të burrave, njerëz këmbëngulës e kurajozë, me një botë të gjerë shpirtërore, me zakone e tradita të spikatura.

Me kontribute të vlerësuara në qarkun e Gjirokastrës

Fisnikëria e këtij fisi doli jashtë hapësirave të Suhës dhe u shqua e dha kontribut të dukshëm gjatë LANÇ-it, ku komisar i batalionit “Misto Mame”, dhe më vonë komisar i batalionit të tretë të Brigadës VIII S, Pano Xhixho, vëllai i Thomait, luftoi dhe ra dëshmor për lirinë e atdheut, në Vishegrad të Jugosllavisë (sot Republika e Bosnjë-Hercegovinës). Nga ky fis doli Thoma Xhixho, që u bë i njohur në hapësirën shqiptare, në fushën e artit e shkencës ushtarake, si dhe të përgatitjes luftarake të ushtrisë. Ai, si ushtarak i lartë, duke përligjur virtytet morale, i ka ngjitur shkallët e gradimeve ushtarake deri në “gjeneralmajor”, si dhe është vlerësuar në jetë dhe është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me urdhra e medalje të ndryshme. Shkolla e mesme, që Thoma Xhixho mbaroi në Gjirokastrë, kurset përgatitore në Itali, akademitë ushtarake në BS, kalitën disiplinën ushtarake, karakterin burrëror dhe moralin e lartë atdhetar.

Thomai, në fillimet e lëvizjes, luftoi si pjesëmarrës aktiv. Në vitet 1942-1944, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) për çlirimin e Shqipërisë, Thoma Xhixho dha një kontribut të vlerësuar në qarkun e Gjirokastrës për organizimin dhe drejtimin e forma-

Gjeneral Thomai ka shërbyer si ushtarak karriere i ushtrisë shqiptare, duke punuar e luftuar në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së atdheut, të forcimit të ushtrisë kombëtare, si dhe të arsimit dhe të shkencës ushtarake shqiptare. Karriera e Thomait është e lidhur në mënyrë të pazgjidhur me historinë e ushtrisë kombëtare, me artin e saj ushtarak, të cilin e mësoi në shkollë, në kurse kualifikimi, në akademi, por dhe në luftëra e beteja, në momente historike që në hapat e parë të karrierës së tij.



cioneve ushtarake partizane, në detyrën e drejtuesit të komandës së vendit, por dhe të komisarit e të komandantit të njësive partizane si kompani, batalion dhe brigadë. Ai arriti të bëhet komisar i Batalionit "Telo Plaku", më vonë komisar i batalionit "Thoma Lula", si dhe në fund, komisar i Brigadës XIX Sulmuese. Luftimet dhe betejat e zhvilluara gjatë LANÇ-it, e bënë Thomain dëshmitar dhe protagonist aktiv në shumë ngjarje e zhvillime kryesore të saj. Në Kongresin e Përmetit atij i akordua grada e lartë për kohën, "major".

Punoi me shpirt për organizimin e ushtrisë shqiptare

Mbas çlirimit, në kushtet e një ushtrie të dalë nga lufta, ushtarakët shqiptarë iu përveshën punës për të ndërtuar, organizuar e përgatitur ushtrinë shqiptare, duke dhënë maksimumin e tyre. Ata i shërbyen atdheut në çdo kohë si mbështetës të lirisë, të pavarësisë dhe në ruajtjen e mbrojtjen e kufijve territorialë të saj.

Në vitin 1945, menjëherë mbas çlirimit, Thomai u

dërgua për studime në Akademinë "Frunze" në BS, dhe pas kthimit në atdhe, me fillimet e organizimit të ushtrisë shqiptare, mbajti mbi supe mjaft funksione drejtuese ushtarake në repartet e njësitë e kësaj ushtrie si, shef shtabi divizioni në Tiranë, në Korçë dhe në Gjirokastrë, në vitet 1947-1950. Me riorganizimin e ushtrisë, në detyrën e komandantit, ka drejtuar Brigadat e Këmbësorisë në Burrel, gjatë viteve 1950-1952, dhe në Gjirokastrë gjatë viteve 1954-1958.

Gjeneral Thomai ka shërbyer si ushtarak karriere i ushtrisë shqiptare, duke punuar e luftuar në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së atdheut, të forcimit të ushtrisë kombëtare, si dhe të arsimit dhe të shkencës ushtarake shqiptare. Karriera e Thomait është e lidhur në mënyrë të pazgjidhur me historinë e ushtrisë kombëtare, me artin e saj ushtarak, të cilin e mësoi në shkollë, në kurse kualifikimi, në akademi, por dhe në luftëra e beteja, në momente historike që në hapat e parë të karrierës së tij. Më tej, ai dha kontributin themeltar

në studimin shkencor dhe përsosjen e tij. Thomai u bë mësues, edukues dhe akademik i rëndësishëm i shkollave tona ushtarake. Komandant i dalë nga lufta popullore, shkencëtar ushtarak si i katedrës ashtu dhe i terrenit, mishërues i instruksionit të qartë e praktik, ai përçoi me pasion, efektshmëri e dashuri artin ushtarak popullor në breza. Gjeneral Thomai kaloi 15 vjet të jetës së tij ushtarake i lidhur me shkollat ushtarake. Për rreth tre vjet, 1952-1954, ishte komandant i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve.

Thomai merr gradën e merituar "gjeneralmajor"

Në vitin 1958, Thomai me gradën kolonel, me vendim të Byrosë Politike të PPSH-së dhe urdhrin e ministrit të Mbrojtjes, u ngarkua të formonte Shkollën e Lartë Ushtarake. Kjo shkollë, në vitin 1961 u emërtua Akademia Ushtarake, ku përsëri gjeneral Thomai u emërua komandant i parë i saj. Në këtë detyrë ai qëndroi deri në mars të vitit 1966. Në vitin 1961 ndoqi studimet në Akademinë "Voroshilov" dhe pas kthimit nga Moska, emërohet përsëri komandant i Akademisë.

Shkollën e Lartë Ushtarake e ngritën nga e para, me përpjekje dhe përkushtim të madh të Thoma Xhixhos

Ushtrisë Popullore. Rreth 800 ushtarakë janë diplomuar në Akademinë Ushtarake në periudhat kur gjeneral Thomai ishte drejtues i këtij institucioni. Vend të rëndësishëm në jetën e tij intensive ushtarake zë edhe emërimi si drejtor i Përgatitjes Luftarake në Ministrinë e Mbrojtjes nga viti 1966 deri në vitin 1972. Gjatë kësaj kohe ai drejtoi përgatitjet e stërvitjeve më të mëdha të ushtrisë, duke qenë edhe pjesëmarrës e kontribuues direkt në zhvillimin e tyre si dhe në hartimin e konkluzioneve të tyre.

Në krye të mendimit teorik dhe praktik të artit ushtarak shqiptar

I rëndësishëm është kontributi i gjeneralit Xhixho në shkencën ushtarake, në përpunimin e dokumenteve më të rëndësishme, në mendimin teorik dhe praktik të artit ushtarak shqiptar, përfshi edhe rregulloret e ushtrisë. Bërthama e përhershme e grupit përgjithësues studimor, i atashuar pranë MMP, përbëhej nga gjeneralët Ernest Jakova, Spiro Shalësi dhe Thoma Xhixho. Në vitin 1963 ky grup hartoi dokumentin kryesor të ushtrisë mbi Artin Ushtarak, i quajtur "Referati i Ministrit të Mbrojtjes", si dhe "Materialin teorik ushtarak" në vitin 1967. Këto dokumente u bënë baza

e referencës dhe udhëheqëse për çdo dokument të mëvonshëm, që lidhej me Artin Ushtarak.

Gjeneral Thomai është autor ose bashkautor në mjaft studime dhe përgjithësime shkencore. Si kryeredaktor i Revistës Ushtarake-Politike në ato vite, kontribuoi për ngritjen e nivelit shkencor të saj edhe me artikuj dhe punime konkrete të botuara në vite. Shkrimet e gjeneral Xhixhos datojnë që nga viti 1951 e deri në vitin 2000.

Në afro tetë dekada nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore janë larguar nga jeta komandantë, komisarë dhe luftëtarë të saj. Ata prehen përjetësisht në tokën shqiptare, që i kushtuan tërë jetën, duke mbetur të gjallë në kujtime, në foto, në relike, në stendat

e muzeve dhe në faqe librash, duke frymëzuar përsëri njerëzit dhe duke ngjallur tek ata ndjenjat e fisnikërisë dhe të atdhedashurisë.

Është në nderin e gjithë shoqërisë sonë t'i nderojë këta idealistë e patriotë, që dhanë gjithçka për këtë popull e këtë vend në situata të vështira lufte, kur kishin përballë pushtuesit nazi-fashistë, kur vërshejllenin mbi kokë plumbat e predhat e artilerisë dhe vunë në shërbim të atdheut gjithçka, kontributin e paharruar, deri dhe jetën e tyre sublime.

Thoma Xhixho dha shumë për ngritjen e Ushtrisë Kombëtare dhe më pas të Ushtrisë Popullore, për arsimin ushtarak, për shkencën dhe mendimin ushtarak shqiptar, për stërvitjet e mëdha ushtarake, si dhe për punën e madhe të bërë për publikimin e mjaft materialeve teoriko-shkencore në revistën politiko ushtarake.



Gjeneral Thomai ka shërbyer si ushtarak karriere i ushtrisë shqiptare, duke punuar e luftuar në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së atdheut, të forcimit të ushtrisë kombëtare, si dhe të arsimit dhe të shkencës ushtarake shqiptare. Karriera e Thomait është e lidhur në mënyrë të pazgjidhur me historinë e ushtrisë kombëtare, me artin e saj ushtarak, të cilin e mësoi në shkolla, në kurse kualifikimi, në akademi, por dhe në luftëra e beteja, në momente historike që në hapat e parë të karrierës së tij.

dhe një stafi oficerësh të lartë. Ky ishte një nga kontributet më të rëndësishme edhe për forcimin e arsimit ushtarak, por edhe për karrierën e tij. Në vitin 1963 Thoma Xhixho gradohet "gjeneralmajor". Në librin e tij gjeneralmajori rus me origjinë shqiptare, Jani Lufi është shprehur: "Thomai merr gradën e merituar 'gjeneralmajor'".

Nga viti 1972 deri sa doli në pension, në vitin 1977, gjeneral Thomai punoi përsëri në Akademi si zëvendëskomandant dhe drejtues i degës shkencore të sapokrijuar. Pas daljes në pension me porosi të ministrit të Mbrojtjes, Mehmet Shehu, gjeneral Thomai së bashku me gjeneral Vehbi Hoxhën dhe kolonel Moisi Elezin u angazhuan deri në fund të vitit 1981 pranë Akademisë Ushtarake, si këshilltarë të jashtëm, duke dhënë ndihmesë me përvojën e tyre të madhe në struktura ushtarake dhe shkencore të



SKËNDERBEGASI PIRRO MANI, REGJISORI I FAMSHËM SHQIPTAR

Pirro Mani është mjeshtër i regjisë e skenave masive, njohës i thellë i mizanskenës. Shfaqjet kulminante janë “Cuca e maleve”, “Fytyra e dytë”, “Arturo Ui”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Epoka para gjyqit”, “Nata e 12 -të”, “Prometeu”, etj. Është angazhuar edhe në disa filma artistikë. Ka fituar shumë çmime dhe është nderuar me titullin e lartë “Artist i popullit”. Prej disa vjetësh jetoi në Nju Jork, SHBA, së bashku me të shoqen, aktoren e mirënjohur Pavlina Mani dhe familjen. Mbetet brilant në disa role (aktor) si në “Loin des barbares”, 1994, Luan Kodra, “I teti në bronz” (1970), “Sali Protopapa”, “Vitet e para” (1965), “Stavri Lara”, etj...

Pirro Mani lindi, më 14 prill të vitit 1932, në Korçë, është aktor dhe regjisor i njohur shqiptar. Është një nga personalitetet më të shquar në historinë e teatrit shqiptar. Regjisor dhe pedagog i shkëlqyer, për 25 vjet punoi në Teatrin Kombëtar. Është një ndër nxënësit e shkollës Ushtarake "Skënderbej", që u bë i famshëm në fushën e artit. Studioi në Institutin Shtetëror të Artit Teatror, GITIS, në Moskë. Pas kthimit në atdhe u emërua regjisor i Teatrit "A. Z. Çajupi", Korçë, të cilin e drejtoi me sukses për rreth tetë vjet. Që nga 1967 – 1992 ka qenë regjisor i Teatrit Kombëtar, ku ka vënë me dhjetëra pjesë teatrale. Në karrierën e tij artistike numëron mbi 80 shfaqje. Është nderuar me shumë çmime. Është mjeshtër i regjisë e skenave masive, njohës i thellë i mizanskenës. Shfaqjet kulminante janë "Cuca e maleve", "Fytyra e dytë", "Arturo Ui", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Epoka para gjyqit", "Nata e 12 -të", "Prometeu", etj. Është angazhuar edhe në disa filma artistikë. Ka fituar shumë çmime dhe është nderuar me titullin e lartë "Artist i popullit". Prej disa vjetësh jetoi në Nju Jork, SHBA, së bashku me të shoqen, aktoren e mirënjohur Pavlina Mani dhe familjen. Mbetet brilant në disa role (aktor) si në "Loin des barbares", 1994, Luan Kodra, "I teti në bronz" (1970), "Sali Protopapa", "Vitet e para" (1965), "Stavri Lara", etj...

...Historia e rrugës së artit për Pirro Manin, ka qenë histori suksesi, por edhe peripecish e vuajtjesh të shumta.... Pirro Manin e kish puthur fati në ballë, se në laboratorët e teatrit korçar pati nën urdhrat e tij regjisorialë, aktorë të klasit të parë, si Pandi Raidhi, bashkëshortët Dhorka dhe Dhimitër Orgocka, Thimi Filipin, Stavri Shkurtin e të tjerë, që Mani s'i hiqte nga goja. Së bashku, ata realizuan vepra me vlera të qëndrueshme e që lanë mbresa në kujtesën e artdashësit, si; "Hijet e Natës" të V. Kokonës,

apo që dëshmuar art të shquar regjisorial dhe aktorial, edhe pse të ngopura me politizime, si "Kënetat" e Fatmir Gjatës, që fituan pëlqimin e autoriteteve. Haraqe si kjo e fundit, bënë të mundur që në skenën e Korçës t'u hapej dera mysafirëve të përjetshëm: Shekspir, Molierit, Bernard Shout, Ostrovskit... Sukseset e ndritshme të farkëtuara në kudhrën e Korçës, e sollën Pirro Manin në teatrin qendror të vendit dhe i hapën atij horizonte më të gjëra e mundësi më të mëdha, por historia që thamë, tamam në ato vite, solli krizat më të mprehta e

rrezikshme se një vepër letrare heretike... Shumë vetë e kanë kollaj t'i venë kryqin teatrit tonë të asaj kohe. Duhet të matesh mirë që të analizosh drejt kulmet e pakta, por të matesh edhe për shtrembërimin e tij, degradimin dhe përdhunimin e tij... Një nga shfaqjet më të bukura të mia, unë mbaj "Rrethimin e Bardhë" të Naum Priftit, që e rrëzoi vetë Enver Hoxha, në një nga vizitat e tij në Korçë. Fabula ishte mbi rezistencën njerëzore në kushtet e rrethimit nga dëbora dhe mendohej se do të kalonte me pasaportën e temës së rrethi-



...Historia e rrugës së artit për Pirro Manin, ka qenë histori suksesi, por edhe peripecish e vuajtjesh të shumta....

Pirro Manin e kish puthur fati në ballë, se në laboratorët e teatrit korçar pati nën urdhrat e tij regjisorialë, aktorë të klasit të parë, si Pandi Raidhi, bashkëshortët Dhorka dhe Dhimitër Orgocka, Thimi Filipin, Stavri Shkurtin e të tjerë, që Mani s'i hiqte nga goja.

dramat më të mëdha shoqërore, që si për të përqeshur artin e skenës, nuk do të ngjiteshin dot kurrë mbi një skenë teatri... Ai kërkoi e gjeti vepra që e bënë atë regjisorin më të mirë të teatrit shqiptar. Ai realizoi "Cucën e Maleve", "Fytyrën e Dytë", "I pazëvendësueshmi", "Epoka para Gjyqit", "Shënomëni dhe Mua", "Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur", që ofronin hapësira të bollshme të frymëzonin regjisorin dhe interpretët, të kënaqnin dhe spektatorët e lozhës dhe ata të platesë.

Ja çfarë shprehte kohë më parë i madhi Pirro Mani:

"Diktatura, e di që një pjesë teatrale me ide të papëlqyeshme për të, është mijëra herë më e

mit kapitalisto-revizionist. Unë u dashurova pas veprës. Sapo kisha ardhur nga Moska, ku destalinizimi po shkrinte çdo lloj akulli. Në tërë katet e Universitetit "Lomonosov" kërciste rock&roll-i nga gëzimi i hapjes së horizonteve. Kurse këtu... Unë arrita që tërë këtë përjetim ta plazmoja në atë dramë. I madhi e kapi menjëherë nostalgjinë time dhe e fundosi atë spektakël aq të ndjerë... Singërisht, ka qenë një nga punët më të bukura që kam bërë... Kam pasur fatin e madh të punoj me skenografë të jashtëzakonshëm si Agim Zajmi, Shaban Hysa, Ksenofon Diloja. Bashkëjetesa me ta më ndihmoi mjaft që të përvetësoja më mirë ligjet e arkitekturës skenike dhe më mprehu kërkesat".

Më 18 gusht të vitit 1953, mes gjimnazistëve që do të nisnin studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej" është dhe Ahmet Shqarri, sot, komentator i njohur sportiv në Shqipëri. Kjo shkollë, është vatra e parë ku spikati talenti dhe dashuria e tij për artin dhe sportin, pasione, të cilëve ai u bashkëngjiti punën dhe përkushtimin e palodhur në më shumë se katër dekada pa ndërprerë. Shqarri u lind në vitin 1939.

Zëri i Ahmet Shqarrit lakohet si transmetues i veçantë pasi solli shumë risi në emisionet sportive shqiptare, në të vetmen radio dhe televizion në hapësirat mbarë shqiptare për vite me radhë. Funksionimi i emisionit special "Nga njëra ndeshje në tjetrën", shënoi një hap cilësor të nivelit botëror për radio transmetimin shqiptar. Tek figura e Shqarrit, nuk ka spikatur vetëm zëri, por ambicia serioze për të hapur dritare të reja komunikimi me dëgjuesit, dritare, të cilat ruajnë dhe sot po atë shkëlqim dhe rrezatim në syrin dhe veshin e dëgjuesit shqiptar.

Nëse paraardhësit e tij janë lakuar si ikonat e para të transmetimit, ai si vazhdues i tyre, e ngriti në pedestal emrin e komentatorit sportiv shqiptar, duke vulosur risi, që do të ngelen si shtatore të pazëvendësueshme. Mazreku, Bellova dhe Shqarri, do të mbeten një treshe simpatike, që hapën epokën e panjohur të transmetimit radiofonik, duke ia kaluar stafetën njëri-tjetrit, për t'u kthyer kështu në emblema që koha i ka përcjellë si figura referimi për të ardhmen e sportit shqiptar-dëgjues. Sipas Shqarrit, ka qenë një rastësi që u bë gazetar sportiv. Ka filluar të shkruajë kur ka qenë në shkollë të mesme. Në revistën "Shqiptarja e Re", botoi "Vajza e braktisur", i cili ishte një tregim... Krahës Fakultetit të Letërsisë, bëri edhe kursin dyvjeçar të gazetarisë, ku kishte pedagogë të tillë si: Vangjush Gambeta, Dritëro Agolli, Hamit Borici. Në sajë të tyre iu dha mundësia të shkruante në shtypin e kohës si: "Zëri i Rinisë", "Puna", "Mësuesi", "Zëri i Popullit", "Bash-



SKËNDERBEGASI AHMET SHQARRI, gazetari i njohur sportiv

kimi". Pra, ka qenë shumë i lidhur me librin. Bënte shumë përpjekje për të kapur librin sa dilte në treg. Duke pasur një dëshirë të madhe për letërsinë, lexonte shumë. Kjo periudhë quhej periudhë prove. Ndërkohë që shkruante për gazeta të tjera, Ismet Bellova që ishte komentator dhe miku i tij, i ofroi të bashkëpunonte me të vetmen gazetë sportive të kohës "Sporti Popullor". Dy komentatorë ishin asokohe, Bellova dhe i madhi Anton

Mazreku. Kur mbaroi studimet universitare, nuk kishte asnjë gazetar të diplomuar që të punonte për sportin në Radio-Televizion. Kështu, ai ishte i pari gazetar profesionist sportiv i një medie elektronike. Starti i karrierës ka qenë pikërisht gushti i vitit 1969, vit në të cilën u hodhën themelet për krijimin e Rubrikës Sportive të rregullt, që në fakt filloi në vitin 1970.

**Kujtim Borici,
Maksim Fejzullai**



110 vjet shtet shqiptar, rrugëtim, sfida, krenari kombëtare



Atdhe, të ndiej edhe në kokrrën e rërës së detit,
Edhe në thërrimen e padukshme të nektarit,
Edhe në pikën e kaltër të vesës së mëngjesit,
Edhe në plisin e vlagët të ugarit.
Atdhe, të ndiej edhe në zhurmën e rrapit të lashtë,
Edhe në fijen e brishtë të barit,
Edhe në qerpikët si kallëza gruri të vashës,
Edhe në vijat e ballit të ushtarit.
Atdhe, të ndiej në çdo qelizë të indit të tokës sime,
E në çdo molekulë të ujërave që më lajnë,
E në çdo fërfërimë ere e frymë suferine,
E në çdo copë qielli që malet mbi kokë e mbajnë.
Atdhe, të ndiej në bulat e djersës së ndershme,
Të ndiej në tingujt e këngëve dhe isot e gjata,
Të ndiej në gurët dhe gdhendjet e hershme,

Të ndiej në lulet e qëndismave të grave të ngrata.
Atdhe, të ndiej në avullin e bukës së magjeve,
Të ndiej në shtigjet e dhive dhe rrugët e makinave,
Të ndiej në shijen e hidhur të tymit të oxhaqeve,
Të ndiej në tërbimin dhe dhimbjen e trimave.
Atdhe, të ndiej në hatullat e zemrës dhe shpirtit,
Të ndiej në zulmën pa cak të rinisë,
Të ndiej në qëndresën e plakjes sime si plakja e Krishtit,

Të ndiej në gjëmimin e madh të historisë.
Atdhe, ku të të ndiej, nëse një ndjenjë qenia ime
do të ketë,

Të them të të ndiej edhe në lëngun e hirit
Atje ku s'ka lëng e s'ka jetë?
Të them se të ndiej edhe në botën reale krejt të
vërtetë. (Dritëro Agolli)

E kush më bukur se vargjet poetike, shpesh të
derdhura në nota muzikore do e identifikonte këtë
ndjenjë atdhedashurie, që me sa duket festat e 28-
29 nëntorit e bëjnë të shpërfaqet dukshëm brenda
trojeve shqiptare dhe përtej oqeanit, kudo ku shqip-
tarët jetojnë pa harruar identitetin e tyre, festojnë
këtë ditë të bekuar.

28 nëntori i parë arbëror është ai i vitit 1443,
kur Kryeheroi ynë, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu e
ngriti për të parë në historinë e këtij kombi Flamurin
me Shqiponjën Dykrenore dhe me yllin gjashtë-cepash
në mes dy krenash, në kalanë e Krujës, ku valoi plot
25 vjet.

Me po këtë forcë dhe vullnet u ngrit, pas 500
vitesh në Vlorën trime, nga "urtësia dhe mençuria"
shqiptare, ati ynë Ismail Qemali, flamuri i kuq.

Ky flamur, larë me gjakun e mijëra shqiptarëve.
Në të shohim qëndrimin e patundur dhe burrëror
të atyre ushtarëve fisnikë që i ka udhëhequr atyre
luftërave të rrepta, jo për sulme por për mbrojtje.

Në të shikojmë jetën e së ardhmes së këtij kombi,
që u dergj shekujsh nën plafin e robërisë, por kurrë
i mundur.

110 vjet më parë, Ismail Qemali deklaroi: "Prej
sot e shpallim Shqipërinë shtet të lirë e të pavarur".

Sot jetojmë të lirë, në tokën që amanet na lanë
të parët. Dhe ne, ua trashëgojmë këtë pasuri të pa-
çmueshme brezave të rinj, si një thesar, për të cilin
duhet të kujdesen si për dritën e syve.

Gëzuar Shqipe, ditën më të bukur, ditën e lirisë, si
më të shenjtën ndjenjë atdhetarie!



PARTNERITETI SPECIAL STRATEGJIK ME SHBA

Në shtator 2023

**MBËRRIJNË NË SHQIPËRI
2 HELIKOPTERË
BLACK HAWK**



PARTNERITETI SPECIAL STRATEGJIK ME SHBA

Në shtator 2023

**KRIJOHET QENDRA
OPERACIONALE E
MBROJTJES KIBERNETIKE**



PARTNERITETI SPECIAL STRATEGJIK ME SHBA

Shqipëria

**VENDI PRITËS I STËRVITJES
DEFENDER EUROPE 2023**



Arritje 2022

13 projekte

PËR BASHKITË PËR REDUKTIMIN E RISKUT
NGA FATKEQËSITË NATYRORE